# GAZETA SHQIPTARE








Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7429 E shtunë 3 Shkurt 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)







Opinioni i Ditës

Nga MONIKA SHOSHORI STAFA

## Libri "Kadare dhe regjimi komunist" është një mision



Ky libër, një mision. Një e vërtetë e parë mes dokumentesh, letrash shkresore dhe jo vetëm, por dhe fakteve. Mua më pëlqen t'u referohem shifrave në punën...

Vijon në faqen 20



Opinioni i Ditës

Nga ARTON KONUSHEVCI

## Qytetarëve u shkelen çdo ditë të drejtat e tyre

Të drejtat e njeriut në Kosovë po shkelen çdo ditë, thonë përfaqësuesit e organizatave dhe institucioneve që merren me mbrojtjen e të drejtat e njeriut...

Vijon në faqen 21



Në banesën e Xhikës gjenden 80 dosje tenderësh

# Tenderët e rrugëve, pranga ish-drejtorëve të LSI-PD, Kryemadhi: Është sulm politik

Prokuroria e Elbasanit: Dashamir Xhika dhe Andi Toma shpërdoruan detyrën. Detajet e akuzës, afera 5 miliardë lekë

Abuzimet e kryera në procedurat tenderuese dhe mbikëqyrëse për ndërtimin e rrugës Elbasan-Gjinar kanë çuar në pranga dy ish-drejtorët e Përgjithshëm të Rrugëve, Dashamir Xhika dhe Andi Toma. Ata u arrestuan me kërkesë të prokurorisë së Elbasanit pas kallëzimit penal të bërë pak kohë më parë nga Ministria ...

Në faqen 7

DETAJET QE I NXOREN TE ZBULUAR DHE ROLET E GJITHSECILIT NE ATENTAT

# EKZEKUTIMI I DEVI KASMIT, ARRESTOHET VRASESI GREK

Historia e ish-policit grek Efthymiou Efthymious, vrasësit me pagesë. Shpallet në kërkim Aurel Hoxhallari, organizatori i atentatit. Dyshimi për atentatin në 2015



(Në foto) Policia në vendin e vrasjes së Devi Kasmit



Efthymiou Efthymious



Aurel Hoxhallari



Eltoh Halipaj

Në faqen 5

DEBATET

## Shqipëri-Greqi, përfundon Traktati i Miqësisë, në fuqi vetëm ligji i luftës Petoshati: Po e diskutojmë

Në faqen 3

RAPORTI FINAL

## Akreditimi, "Luarasi" vlerësohet maksimalisht Gjonça: Universitetet private më të mirët

Në faqen 9

"DIDI NA PERSEKUTONTE"

## 52 vite burg bandës së Lazaratit, Aliko: Policia e shiti drogën tek trafikantët

Në faqen 6

SI TE APLIKONI

## Thjeshtohet në vetëm 14 ditë procedura për punësim në Gjermani, kriteret e dokumentet

Në faqen 22

RREFEHET PREZANTUESJA



## Einxhëll Shkira: Një grua ka abuzuar me mua kur u futa në botën e televizionit

Suplement

Financat: Pagesa e këstit të parë dhe të dytë të dëmshpërblimit pas plotësimit të dosjes

# Ish- të përndjekurit lista me 1000 përfituesit

*Trashëgimtarët duhet të dorëzojnë numrin e llogarisë brenda muajit*

ORNELA MANJANI

Rreth 1000 fëmijët dhe nipërit e ish-të dënuarve politikë do të marrin dëmshpërblimin. Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë joparësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin dokumentet e nevojshme. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të këstit të parë dhe të dytë të dorëzojnë në Drejtorinë e Pagesave numrin ...




Në faqet 10-12

# PAKTI ME GREQINË
## REAGIMET

### Ish-kryeministri u bën thirrje shqiptarëve: Të mbrojmë me çdo çmim vendin

# Pakti detar, Berisha: Pazare të pista Bushati: Shih hallet me drejtësinë

## "4 pyetjet për Ramën, pala greke gjeti karagjozë"

Ish-kryeministri Sali Berisha dhe ministri për Evropën e Punët e Jashtme Ditmir Bushati shkëmbyen dje, sërish replika. Përmes një statusi në "Facebook" Berisha u bëri thirrje shqiptarëve që të përgatiten për të mbrojtur me çdo çmim integritetin e vendit dhe interesin kombëtar, pasi e cilëson marrëveshjen e re mes Shqipërisë dhe Greqisë për detin si anti-kombëtare. Në një reagim të tij, ministri Bushati iu drejtuar dje Berishës me fjalët: "Sali! Ti e kupton më mirë nga të tjerët se ç'faqe e zezë do duket marrëveshja jote e detit së shpejti, ndaj je tërbuar! S'ke ç'i bën, shih hallet me drejtësinë e re". Në reagimin e tij, të mëhershëm, Berisha akuzoi kryeministrin Rama dhe ministrin Bushati për "pazare" me Greqinë.

"Kapitullanti Edi Rama me pazarin e tij të pistë shkelmoi integritetin e vendit dhe interesin kombëtar! U bëj thirrje shqiptarëve të përgatiten për të mbrojtur me çdo çmim integritetin e vendit dhe interesin kombëtar nga dyshja antishqiptare e neo-bllokmenëve Rama-Bushati", shkroi dje, Berisha. Duke komentuar deklaratat e bëra nga Rama gjatë intervistës për gazetarin Sokol Balla, Berisha hodhi poshtë faktin se ishte qeveria shqiptare e Ramës që hapi bisedimet me Greqinë. Sipas tij, "ky është një mashtrim i turpshëm i paskrupullt i tij, sepse pas anulimit, në një akt korruptiv për llogari të një pale të tretë të marrëveshjes së detit të pranuar nga të dy palët, nuk është e vërtetë se Greqia i iku tavolinës përkundrazi ajo kërkoi me insistim bisedime për zgjidhjen e problemit me pazar, vetëkuptohet me këtë lloj zgjidhje me pazar që ajo i imponoi së fundi Ramës". "Ne kundërshtuam në mënyrë të prerë të bisedonim për zgjidhjen me pazar duke insistuar se vendimi i Gjykatës Kushtetuese është ligj dhe do zbatohet dhe se nuk pranojmë të ulemi për të zgjidhur me pazar midis palëve çështjen e kufirit midis dy vendeve. Ne insistuam në mënyrë të prerë se do të pranojmë vetëm zgjidhjen me Gjykatën e Detit. Po shtoj këtu se, pikërisht për të shmangur zgjidhjen me pazar, ne pranuam zgjidhjen me metodën e baraslargimit, metodë kjo e përdorur në 98% të rasteve në zgjidhjen e problemit të kufijve detar në Europë, dhe sipas kësaj metode Shqipëria nuk ka humbur as një metër katror", sqaroi në komentin e tij, Berisha. Sipas ish-kryeministrit, "kjo metodë nuk këshillohet në linjat, kurba të mëdha, pra në rastin e gjireve të mëdhenj. Personalisht e kam pranuar metodën e baraslargimit, sepse as unë dhe asnjëri që i thotë vetes shqiptar nuk mund të pranojë Sarandën si gji i madh dhe nuk mund të mohoje se ishujt grekë plot ndërtesa, shtëpi banimi, shkolla etj. nuk janë të populluar". E duke vijuar sqarimin e tij, Berisha tregoi momentet e mosdakordësisë me palën greke. "Pas largimit nga pushteti, pala greke e pa se kishte të bënte tani me një karabush, përkatësisht neobllokmenët; piktorin dështak Edvin Kristaq Rama dhe Ditzi Bushatin, të cilët për shkak të veprimeve të tyre të papjekura nuk i përfilli për katër vite as për hosh as për balosh dhe arriti t'u diktojë së fundi marrëveshjen aktuale të detit duke marrë për vete gjithçka deshi, si fushat gjigande të gazit dhe naftës, më të mëdhatë në Jon dhe Mesdhe, të zgjerojë nga 6 milje në 12 milje kufirin e ujërave territoriale me Shqipërinë duke u lënë në dorë si shpërblim piktorit dështak dhe Ditzuit, një letër të vdekur, atavizëm të turpshëm për të gjitha qeveritë greke, ligjin e luftës me Shqipërinë",-u shpreh Berisha. Në fund ai i drejton 4 pyetje kryeministrit për paktin me Greqinë.



Ministri për Evropën e Punët e Jashtme Ditmir Bushati



Ish-kryeministri Sali Berisha

## Ish- zv. ministrja: Arsyet pse s'mund të ketë zgjerim në det me më shumë se 6 milje

Ish-zëvendësministrja e Punëve të Jashtme, Edith Harxhi ka komentuar negociatat mes Shqipërisë dhe Greqisë si dhe deklaratën e ministrit të Jashtëm grek, Nikos Kotzias se Shqipëria ka pranuar që Greqia të zgjerojë hapësirën detare me 12 milje. E ftuar në rubrikën 'Opinion' në News24, Edith Harxhi tha se, nëse është arritur kjo marrëveshje, atëherë është një tradhti kombëtare shumë e madhe. Ajo u shpreh se sipas konventës ndërkombëtare nuk mund të ketë zgjerim të hapësirës detare më shumë se 6 milje detare.



"Qeveria po rinegocion fshehurazi marrëveshjen për detin me Greqinë. Shqiptarët janë të ndjeshëm për çështjen detit. Nëse është arritur një marrëveshje dhe dakordësi politike për t'i dhënë Greqisë 12 milje detare, atëherë kjo është një tradhti e madhe kombëtare. Në negociatat mungon takimi i palëve që janë pjesë teknike. Në vitin 2009 ka pasur negociatorë që vinin nga Ministria e Mbrojtjes apo instanca të tjera. Kjo marrëveshje e arritur në vitin 2009 duhet të ishte çuar në një nga gjykatat ndërkombëtare për t'u diskutuar. Sipas konventës mund të merren deri në 6 milje detare dhe jo 12, siç thuhet. Nëse kjo ndodh, ndoshta është për arsye të tjera. Qeveria jep 12 milje detare për votën e Greqisë pro anëtarësimit të Shqipërisë në BE"- tha ish zv. ministrja e Jashtme.




**DEKLARATA**

"Kapitullanti Edi Rama me pazarin e tij te pistë shkelmoi integritetin e vendit dhe interesin kombëtar! U bëj thirrje shqiptarëve të përgatiten për të mbrojtur me çdo çmim integritetin e vendit dhe interesin kombetar nga dyshja antishqiptare e neo-bllokmenëve Rama-Bushati", shkroi dje, Berisha.



### Mesazhi për ministrin grek: Kemi 3 plumba për ju

## Kërcënohen 5 ministra grekë, reagon Kotzias: Më kanë vënë në shënjestër

Ministri i Jashtëm i Greqisë Nikos Kotzias është kërcënuar me vdekje. Ai ka marrë një letër anonime në të cilën shkruhet "Kemi tre plumba për ju". Lajmi është konfirmuar nga ministri i Mbrojtjes së qytetarëve Nikos Toskas. Sipas tij, dikujt nuk i pëlqejnë mënyrat e negociatave mes Athinës dhe Shkupit, për zgjidhjen e çështjes së emrit të Maqedonisë. Në një deklaratë për mediat Toskas tha se kërcënimi nuk është vetëm për Kotzias, por edhe për familjen e tij. "Zoti Kotzias po përpiqet ta zgjidhë çështjen e emrit të Maqedonisë me taktika mjeshtërore, nën urdhrat e kryeministrit"-u shpreh ministri grek, duke theksuar se qëllimi i letrës është nxitja e terrorit. Ministri i Jashtëm grek Kotzias, me anë të një postimi në "Twitter", i bëri thirrje Partisë Demokracia e Re dhe Sinodit të Shenjtë, të dënojnë me çdo kusht kërcënuesit. "Prej vitesh sisteme të caktuara, kanale dhe shtypi i shkruar, synojnë të shpifin për mua. I shqetëson fakti se nuk më mban askush. Ata janë nxitës të kërcënimeve. Pres që partia Demokracia e Re dhe Sinodi i Shenjtë t'i dënojë me çdo kusht". Autoritetet greke po hetojnë për të zbardhur autorët e kërcënimit të shefit të diplomacisë. Kërcënimi vjen vetëm pas takimeve që ndërmjetësi i OKB-së, Methju Nimiç zhvilloi me zyrtarë të lartë të Maqedonisë e Greqisë. Kotzias njoftoi kryeministrin grek Aleksis Tsipras mbi ecurinë e negociatave, si dhe për vendosjen e një date për takimin e radhës në Selanik mes tij dhe homologut maqedonas Dimitrov. Mësohet se janë edhe 4 ministra të tjerë që janë kërcënuar.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu:*** Cel:0682074415-***email:marketing@gazetashqiptare.com***, **ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu:*** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**




Elida Petoshati, drejtore e rajonit në MEJP: Po diskutojmë me palën greke

# Shqipëri-Greqi, përfundon Traktati i Miqësisë, në fuqi vetëm ligji i luftës

## Shehu sqaron detajet. Braho: Jemi në luftë prej 48 orësh

Darina Tanushi

Mes Shqipërisë dhe Greqisë nuk ka më as traktat miqësie. Vetëm 3 ditë më parë ky traktat ka skaduar, pikërisht më 31 janar. Elida Petoshati, drejtore e Drejtorisë së Rajonit në Ministrinë e Jashtme e konfirmoi gjithashtu gjatë emisionit "Debati në Channel One", të gazetarit Roland Qafoku. "Ky traktat mbaron këtë vit. Në fund të shkurtit të këtij viti mbaron efekti, por ne jemi në diskutime me pakën greke për ta pasuruar atë dokument me elemente e reja, me zhvillimet e reja. Traktati i Miqësisë është akti më i lartë politik që sanksionon marrëdhëniet, moscenimin e integritetit territorial", u shpreh Petoshati. Sipas saj, "së shpejti presim që pala greke të abrogojë në mënyrë të njëanshme ligjin e luftës dhe në këtë mënyrë qindra qytetarë shqiptarë dhe entitete të kenë mundësinë të rikuperojnë pronat e tyre". Kjo deklaratë ka sjellë reagime të shumta, ndërkohë që prej ditësh po kritikohet fakti se qeveria shqiptare po mban të fshehta negociatat me qeverinë greke. Ndërkohë ish-ministri i Jashtëm i PD-së, Tritan Shehu e sqaroi me detaje këtë fakt. "Thuhet se drejtoresha e Rajonit ka deklaruar që më 31 janar 2018 ka skaduar Traktati i Miqësisë së Shqipërisë me Greqinë. Deri tani nuk ka asnjë përgënjeshtrim zyrtar nga kjo ministri për këtë të pavërtetë. Në këto kushte dëshiroj të informoj publikun se kemi të bëjmë me një deklarim spekulativ, për të cilën ajo ministri duhet të shprehet", u shpreh Shehu në një postim në rrjetin social "FB". Sipas tij, "Traktati i Miqësisë me Greqinë është firmosur më 21 mars 1996. Ky traktat ka hyrë në fuqi më 5 shkurt 1998. Koha e veprimit të tij është 20 vite. Më tej ai automatikisht zgjatet çdo 5 vite, në qoftë se deri një vit para skadencës palët nuk kanë bërë kërkesë për ta shfuqizuar ose ndryshuar, gjë që deri tani nuk rezulton e tillë. Pra, ky traktat pluridimensional dhe thelbësor vazhdon të jetë në fuqi së paku për pesë vitet e ardhshme", u shpreh Shehu. Ai ka postuar edhe tekstin e plotë të nenit përkatës të këtij traktati. Reagim tjetër erdhi dje edhe nga zyrtarja e PDIU-së, Vjollca Braho, e cila jep alarmin. "Zyrtarisht, pas skadimit të Traktatit të Miqësisë, prej 48 orësh Shqipëria është në gjendje lufte me Greqinë! Një heshtje e pakuptimtë nga ana e autoriteteve shtetërore shqiptare, që e neglizhojnë këtë fakt duke u justifikuar me idenë se pavarësisht skadimit të afatit të Traktatit të Miqësisë, nuk ka probleme sepse rifirmosja e tij do të jetë pjesë e negociatave që po zhvillohen mes dy vendeve", u shpreh dje Braho. "Nuk mundet që në vitin 2018 të ketë ende situata të errëta mes dy fqinjëve që pretendojnë për marrëdhënie të shkëlqyera, ndërkohë që sot, në fakt, kanë ndërmjet ligjin e luftës. Ne jemi për fqinjësi të mirë, por ama kundër nënshtrimit!", deklaroi dje Braho. Sipas saj, "nuk mund të ketë marrëveshje të drejtë mes dy vendeve pa folur dhe zgjidhur çështjen çame. Çështje, e cila pret drejtësinë e munguar për t'i kthyer dinjitetin një krahinë që është masakruar për faktin e vetëm se banorët e saj ishin shqiptarë myslimanë".



Elida Petoshati, drejtore e Drejtorisë së Rajonit në Ministrinë e Jashtme



Neni 20

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë prej 20 vjetësh dhe do t'i nënshtrohet ratifikimit në bazë të procedurave kushtetuese të secilës Palë, por do të hyjë në fuqi ditën e shkëmbimit të instrumenteve të ratifikimit.

Fuqia e kësaj Marrëveshjeje do të ripërtërihet automatikisht për një periudhë të re prej pesë vjetësh, me përjashtim kur njëra nga Palët Kontraktuese i komunikon me shkrim Palës tjetër vendimin e vet për ta denoncuar, të paktën një vit para përfundimit të periudhës përkatëse.

Bërë në Tiranë më 21 mars 1996, në dy kopje të njëllojta, në gjuhën shqipe dhe greke, të cilat kanë të njëjtën fuqi.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
MINISTRI I PUNEVE TE JASHTME

PËR REPUBLIKËN GREKE
MINISTRI I PUNEVE TE JASHTME

Faksimile e nenit 20 të Traktatit të Miqësisë mes Shqipërisë dhe Greqisë, nënshkruar më 1996

**TRITAN SHEHU**

"Traktati i Miqësisë me Greqinë është firmosur më 21 mars 1996. Ky traktat ka hyrë në fuqi më 5 shkurt 1998. Koha e veprimit të tij është 20 vite. Më tej ai automatikisht zgjatet çdo 5 vite, në qoftë se deri një vit para skadencës palët nuk kanë bërë kërkesë për ta shfuqizuar ose ndryshuar, gjë që deri tani nuk rezulton e tillë. Pra, ky traktat pluridimensional dhe thelbësor vazhdon të jetë në fuqi së paku për pesë vitet e ardhshme", u shpreh Shehu.

**VJOLLCA BRAHO**

"Zyrtarisht, pas skadimit të Traktatit të Miqësisë, prej 48 orësh Shqipëria është në gjendje lufte me Greqinë. Një heshtje e pakuptimtë nga ana e autoriteteve shtetërore shqiptare, që e neglizhojnë këtë fakt duke u justifikuar me idenë se pavarësisht skadimit të afatit të Traktatit të Miqësisë, nuk ka probleme, sepse rifirmosja e tij do të jetë pjesë e negociatave që po zhvillohen mes dy vendeve", tha Braho.

### Traktati i Miqësisë u nënshkrua, ndërsa ligji i luftës ishte në fuqi

Edhe pse Greqia mbante ende ligjin e luftës të vendosur në vitin 1940, më 31 mars të vitit 1996, në kohë kur në pushtet ishte Partia Demokratike dhe Sali Berisha President i Republikës, nënshkroi Traktatin e Miqësisë. Për afro 22 vite ky traktat ishte në fuqi dhe komentohej si një nga arritjet më të mëdha të diplomacisë shqiptare, por edhe asaj greke. Madje, sa herë diskutohej dhe përmendje ligji i luftës, pala greke argumentonte se ky ligj ishte nul për faktin se mes dy vendeve ekziston Traktati i Miqësisë, si forma më e lartë e bashkëpunimit. Por, aktualisht ne jemi në stadin që ky traktat nuk ekziston, për shkak të skadencës dhe e vetmja gjë që është aktualisht në fuqi është ligji i luftës që Greqia ka ndaj Shqipërisë. Por, historia e vetë traktatit është një ligj që nuk është zbatuar, sidomos nga pala greke. Në vitin 2016 qeveria shqiptare dhe qeveria greke nisën bisedimet dypalëshe për të zgjidhur një sërë problemesh të mbetur pezull. Mes tyre ishte edhe rinovimi i Traktatit të Miqësisë. Në atë kohë ministri i Jashtëm i Greqisë, Nikos Kotzias, deklaroi se "ne duam të ripërtërijmë, për të përmirësuar atë", por tashmë kanë kaluar 48 orë nga skadimi i këtij traktati dhe aktualisht e vetmja gjë e shkruar zyrtare është ligji i luftës, që Greqia ende e ka në fuqi.

### Pakti detar, studiuesi zbulon komunikimin e qeverisë amerikane

# Dervishi: SHBA notë për Shqipërinë në 1989, shtrirja në det 12, jo 15 milje

Studiuesi i njohur Kastriot Dervishi ka zbuluar dje dokumentin që na njeh me një komunikim të qeverisë amerikane dhe asaj shqiptare në vitin 1989 për bregdetin shqiptar. "Në vitin 1989 ka pasur një komunikim të tërthortë midis qeverisë amerikane dhe asaj shqiptare me ndërmjetësinë e qeverisë franceze, në lidhje me bregdetin shqiptar. Nota e nisur nga Parisi më 21 qershor 1989 vinte në dukje se qeveria komuniste mbante si kufi detar, largësinë prej 15 miljesh (27 km e 780 m), në një kohë që duhej ta kishte sipas Konventës së Detit të vitit 1982, në 12 milje (22 km e 224 m). Komunistët, të veçuar nga bota, pa njohje me traktatet ndërkombëtare, e trajtonin kufirin detar të vendit si çështje të brendshme, të paharmonizuar me ligjet ndërkombëtare, në mbështetje të dekreteve të Presidiumit të Kuvendit Popullor të viteve 1970 dhe 1976. Shqipëria ishte në atë kohë në një qëndrim me shtete si Ekuadori, Guineja dhe Peruja, duke përbërë një katërshe problematike", shprehet studiuesi. "Pasi nota amerikane erdhi në Tiranë, u ngrit një grup pune me 4 persona. Në përfundim, ministri i Punëve të Brendshme, Simon Stefani, la shënimin se Shqipëria do vazhdonte të vepronte me dekretin e vitit 1976", thuhet nga studiuesi Dervishi.



SHOKU SIMON !

Po ju dergojme relacionin e pergatitur nga nje grup shokesh per disa probleme te ngritura nga Qeveria e SHBA lidhur me gjeresine dhe regjimin e ujrave tona territoriale.

Me daten 6.?.1989 mbi baze te nje shkre-se te derguar nga shoku ... Plaka me shokun

Faksimil e porosisë së SHBA për Shqipërinë

**NOTA E QEVERISË AMERIKANE (EKSTRAKT)**

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës i paraqet përgëzimet e veta Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Francës dhe ka nderin t'i kërkojë ndihmë në transmetimin e informacionit që vijon qeverisë së Shqipërisë: Shtetet e Bashkuara të Amerikës i referohen dekretit shqiptar nr.5384, datë 23.2.1976, që ndryshon dekretin nr.4650, datë 9.3.1970, i cili kërkon të vendosë një det territorial prej 15 miljesh detare, që ndryshon sistemin e vijave bazë të drejta jashtë mase dhe që ka për qëllim të porosisë se anijet e huaja të luftës mund të hyjnë ose kalojnë nëpër detin territorial vetëm me autorizim të veçantë. Deklarimi i detit territorial me 15 milje detare nuk mbështetet nga parimet e vendosura të së drejtës ndërkombëtare dhe praktika e shteteve. Siç është e mirënjohur, e drejta ndërkombëtare, siç reflektohet në nenin 3 të Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1982 mbi të drejtën e detit, njeh një gjerësi të detit territorial deri në një kufi që nuk kapërcen 12 milje detare, të matur nga vijat bazë të përcaktuara në përputhje me Konventën. Kjo praktikë është ndjekur nga shumica e shteteve bregdetare.

KRYEPROKURORJA
SHKARKIMI

Akuza e PD-së, pas marrëveshjes Xhafaj-Marku: I bën hetimet të pavlefshme

# Debatet për shkarkimin, PD: Kryeprokurorja, zgjatim i Ramës

## *Amendamentet e opozitës votohen më 15 mars*

**MARRËVESHJA**
Marrëveshja Xhafaj-Marku u kundërshtua dje nga opozita, duke e cilësuar antikushtetuese. Marrëveshja mes ministrit dhe kryeprokurores Marku u firmos pikërisht në momentin kur Kuvendi po diskutonte nismën e opozitës për shkarkimin e saj.

Valentina Madani

PD-ja paraqiti dje për para Komisionit të Ligjeve dhe Këshillit të Legjislacionit kërkesën për ndryshimin e Kushtetutës, shkarkimin e Arta Markut dhe zgjedhjen e një tjetër Prokurori të Përgjithshëm të përkohshëm. PD mbrojti në këshill amendamentin e saj kushtetues për të shkarkuar Prokuroren e Përgjithshme, Arta Markut dhe zgjedhjen e një kryeprokurori të ri me 84 vota, që të ketë kaluar vetingun. Pasi denoncoi rastin e ish-ministrit Saimir Tahiri dhe ekstradimin e Nezar Seitit, deputeti Enkelejd Alibeaj tha se ky amendament është shpëtimi i reformës në drejtësi dhe hapje e rrugës për integrimin e vendit në Bashkimin Europian. Sipas tij, Prokurori i Përgjithshëm është shndërruar në zgjatim të kryeministrit. Demokratët argumentuan se pse kërkojnë shkarkimin e Markut, kur rendisin se çfarë ka ndodhur që nga dita që ajo ka hyrë në zyrë. "Kërkesa jonë ka 3 çështje: 1. Emërimi i një prokurori të përkohshëm jopolitik me 3/5. 2. Prokurori të zgjidhet me veting 3. Mekanizëm zhbllokues për situatën. Gjykatësi kushtetues më i vlerësuar nga vetingu të jetë Prokurori i Përgjithshëm i përkohshëm. Arsyet pse ne e kërkojmë këtë është vendimi i 18 dhjetorit, ku në shkelje të Kushtetutës u emërua Prokurori i Përgjithshëm pa veting dhe në mënyrë të njëanshme. Nazer Seiti u ekstradua, Orest Sota u lirua nga burgu, Saimir Tahirit iu rikthye pasaporta, por edhe shumë çështje të tjera po shkojnë drejt dyshimit pas 18 dhjetorit dhe këtej", tha Alibeaj. Por, për socialistët është e kundërta, jo shpëtim, por varrosje e reformës. "E përkthej shqip-shqip, jo shpëtim por varrosje të reformës në drejtësi", tha socialisti Ulsi Manja. Palët ranë dakord ta shqyrtojnë këtë amendament, duke caktuar ekspertët dhe relatorët, ndërsa në datë 15 mars kërkesa për ndryshimin e Kushtetutës do të votohen në parlament.

**SHKELJA**

PD-ja akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se ka vendosur një kryeprokurore private për të mbyllur dosjet hetimore. Demokratët këtë akuzë e bazojnë tek marrëveshja që është nënshkruar mes kryeprokurores Marku dhe ministri Xhafaj. Sipas PD-së, marrëveshja është në kundërshtim me Kushtetutën. Për të evidentuar pikërisht shkeljen e saj, tre zyrtarë të lartë të PD-së Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj dhe Gazmend Bardhi dolën para mediave duke akuzuar se prokuroria vihet në shërbim të kryeministrit përmes marrëveshjes Xhafaj-Marku. "E gjithë kjo ndodh në një moment shumë kritik, ku Gjykata Kushtetuese në vetvete po përballet me një kolaps të vazhdueshëm, që nuk po arrin dot më të marrë vendime dhe bllokohet në mënyrë të qëllimshme ngritja në numër të plotë e Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që këto veprime antikushtetuese të mos zhbëhen përmes kësaj gjykate. Shteti i së drejtës bazuar në Kushtetutë dhe ligj ka rënë, sot bazohet në memorandume që qarkullojnë nëpër zyrat e pushtetit, por jo Kushtetuta dhe ligji. Qëllimi është i thjeshtë, Edi Ramës kryeministër të zhytur në zullumet e krimit dhe korrupsionit i duhet një prokuror privat i përkohshëm", deklaroi z.Bylykbashi. Kurse z.Alibeaj u shpreh: "Marrëveshja e shndërron SPAK-un në një trup prokurorësh politikë dhe të besuar të Edi Ramës, pa veting, prej komisioneve të vetingut, pa ONM, që kalojnë vetëm filtrin e Fatmir Xhafajt. Dhe së fundi, që janë nën urdhrat e drejtpërdrejtë, tashmë jo në mënyrë okulte, por të shkruar e zeza mbi të bardhë të drejtuesit të SPAK-ut me emrin Edi Rama. Ky është ndryshimi. Ky është fundi pa lavdi i reformës në drejtësi". Eksperti ligjor, Gazmend Bardhi argumentoi në terma teknikë se kjo marrëveshje zhbën Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Prokurorinë, duke theksuar se hetimet ndaj krimit dhe korrupsionit të bëhen të pavlefshme. "Nxitimi për të krijuar këto seksione në kushtet kur ne jemi në prag të ngritjes së KLP dhe SPAK-u, që sipas ligjit krijohet vetëm brenda 2 muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, tregon se synimi i kësaj marrëveshjeje është heqja e dosjeve nga duart e prokurorëve që sot i hetojnë këto çështje; kalimi i çështjeve penale, përfshi dosjen e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri në duart e prokurorëve besnikë, me qëllim që ajo të mbyllet ende pa u krijuar Prokuroria e Posaçme Antikorrupsion, ajo që ne e njohim me termin SPAK", u shpreh z.Bardhi.




**AMENDAMENTET**
Palët ranë dakord ta shqyrtojnë amendamentin e PD-së për shkarkimin e Markut, duke caktuar ekspertët dhe relatorët, ndërsa në datë 15 mars, kërkesa për ndryshimin e Kushtetutës do të votohen në parlament.

### MB: Prokuroria, autoriteti i vetëm për hetimet

## Hetimi i grupeve kriminale, task-forcë për zbatimin e "Forca e ligjit"

Ministri Brendshëm, Fatmir Xhafaj dhe kryeprokurorja Arta Marku firmosën memorandumin e bashkëpunimit mes dy institucioneve për vendosjen në zbatim të aksionit kombëtar "Forca e ligjit". Nënshkrimi i dokumentit u bë dje në zyrat e Prokurorisë së Përgjithshme. Prokuroria zbardhi dje pikat e marrëveshjes mes Arta Markut dhe ministrit Fatmir Xhafaj për hetimin e grupeve kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Memorandumi i bashkëpunimit është për krijimin e task forcës qendrore që do të ekzekutojë operacionin "Forca e ligjit". Ndër të tjera, thuhet se Prokuroria e Përgji-thshme merr përsipër që të krijojë një seksion të posaçëm të përkohshëm në Prokurorinë për Krime të Rënda dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Gjiroka-stër dhe



Lezhë. Gjithashtu, kompetenca e këtyre seksioneve do të jenë krimet në fushën e krimit të organizuar, trafikut të narkotikëve, korrupsionit, krimit në ekonomi, krimet e kryera nga subjekte të posaçme. Prokurorët që do të caktohen në seksionet e posaçme do t'i nënshtrohen paraprakisht procesit të vetingut. Marrëveshja ngarkon Ministrinë e Brendshme të sigurojë mjete pune dhe ambiente për prokurorët dhe trupën operacionale, të bashkëpunojë ngushtë me prokurorët e sektorëve që do krijohen në Tiranë e rrethe. Gjithashtu, Ministria e Brendshme garanton edhe ruajtjen fizike dhe sigurinë për prokurorët që do të punojnë në sektorët e zbatimit të "Forca e ligjit". Ndërsa, akuzave të opozitës për marrëveshjen e nënshkruar midis kreut të Ministrisë së Brendshme dhe kreut të Prokurorisë së Përgjithshme, ministri i konsideron si shqetësime të pakuptimta, duke nënvizuar se nuk është hera e parë që firmosen marrëveshje të tilla. Ministria jep edhe një shpjegim, duke theksuar se në kushtet kur krimi sofistikohet dhe vepron pa barriera burokratike, institucionet nuk mund të luftojnë secili në parcelën e vet. Ministria thekson se respekton autoritetin e vetëm të prokurorisë në drejtimin e hetimeve.




## Marrëveshja, LSI: Shkelje e Kushtetutës, të anulohet

Nënkryetari i LSI-së, Luan Rama kundërshtoi dje marrëveshjen e nënshkruar mes Ministrisë së Brendshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme. Rama tha se kjo marrëveshje është në shkelje të ligjit dhe Kushtetutës, sepse institucionet janë të detyruara të zbatojnë ligjin dhe nuk është e nevojshme një marrëveshje e tillë. Rama kërkoi anulimin e kësaj marrëveshjeje dhe bërjen nul nga nënshkruesit. "Në emër të LSI-së dhe në emër të zbatimit të Kushtetutës dhe ligjit, kërkoj anulimin e kësaj marrëveshjeje, bërjen e saj nul nga ata që e kanë nënshkruar, sepse ligjërisht nuk ka asnjë vlerë. Reforma në drejtësi presupozon autoritet ligjor të institucioneve që ligji iu jep tagrin të ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Nëse duam realisht implementimin korrekt të reformës në drejtësi, le të krijojmë institucionet sipas frymës së Kushtetutës", tha z.Rama.

**PETRIT VASILI**
Kreu i grupit të LSI, Petrit Vasili tha: "Marrëveshja e Arta Markut me Fatmir Xhafajn është si ALUIZNI i drejtësisë për të legalizuar dy drejtësi: një drejtësi të padënueshmërisë për kryeministrin dhe një drejtësi për shqiptarët e thjeshtë", - tha Vasili.

## VRASJA NE TIRANE
### ARRESTIMET


Aurel Hoxhallari, i dyshuar si organizator i vrasjes


Elton Halipaj


Ish-polici grek Efthymiou Efthymious

"Killeri", ish-polici grek Efthymiou Efthymious, bien në pranga edhe tre bashkëpunëtorët

# Ekzekutimi i Devi Kasmit, kapet grupi i vrasësve

## *Shpallet në kërkim Aurel Hoxhallari, organizatori i atentatit*

Ina Allkanjari

Disa ditë pas atentatit mafioz në Tiranë ku u vra 41-vjeçari Devi Kasmi, policia ka vënë në pranga ekzekutorin dhe bashkëpunëtorët e tij, ndërsa është shpallur në kërkim organizatori. Bëhet me dije se vrasësi është shtetasi grek Efthymiou Efthymious, ish-pjesëtar i forcave speciale greke, që dyshohet se aktualisht bën rolin e vrasësit me pagesë. Ndërkohë në një konferencë për shtyp drejtori i policisë Tiranë, Ardi Veliu, kanë rënë në pranga bashkëpunëtorët Elton Halipaj, Malvin Dinellari, Elton Hoxhallari dhe është shpallur në kërkim shtetasi Aurel Hoxhallari, që dyshohet të jetë organizatori i këtij grupi të strukturuar kriminal.

**HETIMI**

Dyshimet se një shtetas i huaj ishte i përfshirë në ekzekutimin mafioz që tronditi Tiranën, u ngritën menjëherë sapo të afërmit e Kasmit informuan policinë se njeriu i tyre tri ditë përpara se të vritej kishte pasur një debat në palestër, me një person që nuk ishte shqiptar, të huaj. Sipas tyre, personi në fjalë ishte i gjatë rreth 1.80 dhe mbante mjekër. Me këto karakteristika e përshkroi edhe Mario Meshini, personin që i qëlloi para syve ishmikun e tij, të cilin dyshohet se e nxori në pritë. Në dritën e këtyre fakteve, grupi i hetimit të kërkim të një vrasësi me pagesë i ardhur nga vendet fqinje.


Viktima Devi Kasmi

Në fakt, 72 orë më vonë, në pranga përfundoi ish-efektivi i forcave special Greke, Efthimiu Efthimias, i cili dyshohet se qëlloi Kasmin kundrejt një shume të majme eurosh.

**ROLET**

Drejtori i Tiranës Ardi Veliu gjatë deklaratës për shtyp bëri të ditur rolet e të arrestuarve në ekzekutimin e Devi Kasmit. Mësohet se shtetasi grek, Efthymiou Efthymious ka ekzekutuar 41- vjeçarin. Në momentin e arrestimit, atij iu gjetën me vete një sasi e konsiderueshme eurosh dhe parash shqiptare, që dyshohet se i ka përfituar si shpërblim për vrasjen. Efthymious rezulton të ketë qenë punonjës i policisë greke prej vitit 1992 deri në vitin 2012 kur u përjashtua, sepse rezultoi se merrej me trafikim të lëndëve narkotike. Ndërkohë Elton Halipaj ka siguruar mjetet e nevojshme për kryerjen e krimit, Malvin Dinellari ka siguruar mjetet dhe ka përgatitur infrastrukturën për realizimin e vrasjes, Elton Hoxhallari dyshohet si bashkëpunëtor në sigurimin e mjeteve dhe përgatitjen e infrastrukturës për realizimin e vrasjes ndërsa Aurel Hoxhallari, i cili është shpallur në kërkim dyshohet si organizatori. Ardi Veliu gjatë konferencës për shtyp, nuk dha të dhëna në lidhje me rolin e të arrestuarit tjetër si bashkëpunëtor Mario Meshini, apo të shpallurin në kërkim Domard Konjari, pasi sipas tij janë pjesë e sekretit hetimor. Sakaq bëhet me dije se gjatë këtij operacioni të koduar "Enigma", janë ushtruar kontrolle në disa banesa të autorëve të dyshuar, si dhe në një vilë në periferi të Tiranës, e cila është në pronësi të organizatorit Aurel Hoxhallarit. Mësohet se vila shërbente si bazë e këtij grupi kriminal. Nga kontrolli në vilë është gjetur një arsenal armësh, municionesh, eksplozivësh, raketa hedhës, armë të precizonit të lartë, minë me telekomandë, dylbi, radio ndërlidhje (si ato të policisë), të cilat funksiononin në grup, maska, veshje kamuflazhi, etj.

**AUREL HOXHALLARI**

Altin Aurel Hoxhallari, shtetasi me dy emra, që arriti t'i shpëtojë sërish policisë, në vitin 2015 u arrestua nga uniformat blu së bashku me kushëririn e tij, Amarildo Hoxhallari, pasi dyshoheshin si porositësit e vrasjes së Pajtim Serjanit, njëri prej miqve të Emiljano Shullazit. Në atë kohë, dy kushërinjtë Hoxhallari dyshohet se i kishin siguruar kushtet dhe mjetet e nevojshme të dyshuarit Arjanit Sterio për të kryer ekzekutimin e Serjanit, ku nga shkëmbimi i zjarrit me policinë mbeti i vdekur atentatori Sterio. Por për mungesë provash ndaj Aurelit, gjykata e la atë të lirë.

**FATMIR XHAFAJ**

Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj ka përshëndetur aksionin për arrestimin e autorëve të vrasjes së Devi Kasmit në Tiranë. Ai shpreh bindjen për një bashkëpunim shumë të mirë të policisë së Tiranës dhe prokurorisë. "Operacion i shkëlqyer: Identifikim & arrestim rekord i autorëve të dyshuar të vrasjes në Tiranë. Falënderim Policisë Tiranë për profesionalizmin e treguar. Faleminderit prokurorisë Tiranë për bashkëpunimin shumë të mirë. Të bindur për të tjera rezultate pozitive"-shprehet ai.

### Avokati: Të merren pamjet filmike dhe të vërtetohen faktet

## Gjykata lë në burg Mario Meshinin, Prokuroria: Dyshohet si bashkëpunëtor i vrasjes së Devi Kasmit

Mario Meshini, 25-vjeçari, i cili u arrestua një ditë pas vrasjes së Devi Kasmit, nën akuzën e bashkëpunëtorit të autorëve të atentatit, u përball ditën e djeshme me trupën gjykuese. Krimet e Rënda caktuan masën e sigurisë "arrest me burg" për Meshinin, për akuzat e vrasjes me paramendim, kryer në bashkëpunim në rolin e ndihmësit dhe armëmbajtjes pa leje. Ky vendim u mor nga gjykatësja Ardiana Bera, sipas kërkesës së bërë nga organi i akuzës, ku në bazë të provave, që prokuroria disponon, thuhet se nga rrëfimet e dëshmitarëve i dyshuari Meshini ishte nën shoqërinë e Kasmit kur këtë të fundit e qëlluan për vdekje me pesë plumba. Gjatë seancës për caktimin e masës së sigurisë ndaj Meshinit, avokati i tij Ferdinand Doja, kërkoi nga prokuroria të marrë pamjet filmike dhe të vërtetojë këto fakte, duke këmbëngulur se i mbrojturi prej tij nuk kishte lidhje me krimin. 25-vjeçari dhe avokati i tij mbrojtës theksojnë se ai ishte shok me viktimën. Por pozitën e Meshinit në krim e rëndon edhe fakti se pas krimit 25-vjeçari nuk shkoi në polici të kallëzonte ngjarjen.


Mario Meshini

## Detar Hysi rrëzon deklaratën e Sali Berishës

# 'Nezar Seiti bashkëpunëtor i drejtësisë', avokati: Klienti im nuk ka kërkuar të jetë rrëfimtar


Detar Hysi

Avokati i Nezar Seitit, financierit të grupit kriminal "Habilaj", reagoi ditën e djeshme lidhur me ekstradimin e tij drejt Italisë. Reagimi i tij erdhi një ditë pas deklaratës së ish-kryeministrit Sali Berisha, i cili tha se largimi i Seitaj në shtetin fqinj u bë dy ditë pasi kishte deklaruar se do të bëhej bashkëpuntor i drejtësisë për çështjen 'Habilaj'. Avokati, Detar Hysi rrëzoi deklaratën e ish-kryeministrit, duke sqaruar qëndrimin e klientit të tij. Ai tha se Seitaj nuk ka kërkuar të jetë rrëfimtar në këtë çështje."Nisur edhe nga përmasat mediatike që ka marrë çështja e klientit tim, dua të sqaroj nëpërmjet jush, opinionin publik se me përgjegjesinë ligjore, klienti im, në asnjë rrethanë nuk ka kërkuar të jetë rrëfimtar në çështjen e njohur si Habilaj. Nisur edhe nga deklaratat politike, deklaroj me përgjegjësinë e mbrotjes se i pandehuri Nezar Seiti nuk ka dhënë pëlqimin në asnjë fazë të hetimit edhe procedimit penal, qoftë në vend, qoftë në Itali. Klienti im nuk ka njohje me disa nga të pandehurit e çështjes në hetim. Kjo e vë atë në pozita të tjera procedurale, të cilat do të dalin gjatë hetimit me ndryshimin e masës së arrestit", deklaroi Hysi. Më herët avokati ka paralajmëruar se do të kryejë një kallëzim penal për prokurorët e Krimeve të Rënda për ekstradimin e klientit të tij në Itali. Sipas tij drejtuesi i Prokurorisë për Krimet e Rënda ka shpërdoruar detyrën duke tejkaluar kompetencat. Hysi u shpreh se ekstradimin i Seitit u lejua pa prova dhe fakte në shtetin tonë, por vetëm duke u nisur nga përgjimet e palës italiane. Ndonëse i dyshuari kishte shprehur vullnetin për t'u ekstraduar, sipas avokatit duhej më përpara që të përfundonte procedimi penal te Krimet e Rënda.

## Ngjarja në vitin 2014, ja vendimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda për 5 personat e akuzuar

# 52 vite burg bandës së Lazaratit, Aliko: Policia e shiti drogën tek trafikantët

## "Didi na përndiqte se jemi demokratë, donte të bënte fshatin zap në shenjë hakmarrje për plagosjen në '98-ën"

**TIRANË**

Gjykata e Krimeve të Rënda dje ka dënuar me 52 vjet burg në total 5 anëtarët e grupit "Lazarati" të akuzuar për kundërshtim të forcave të policisë gjatë superaksionit antikanabis që u ndërmor në fshatin "rebel" në vitin 2014. Gjatë seancës gjyqësore, njëri prej të arrestuarve dhe konkretisht Arbjon Aliko tentoi të bënte një mbrojtje politike duke akuzuar ish-kreun e Policisë së Shtetit, Artan Didi se ka persekutuar atë dhe gjithë fisin Aliko. Sipas tij, Didi e ka përndjekur dhe është kthyer të bënte zap fshatin Lazarat në shenjë hakmarrje për plagosjen në vitin 1998. Gjatë seancës, Aliko bëri akuza të forta edhe ndaj ishminsitrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, duke thënë se policët e tij ua shisnin drogën trafikantëve. "Artan Didi na ka përndjekur, sepse jemi demokratë. U kthye në fshat për ta bërë zap. Unë i kam parë vetë se si ngarkoheshin blindat e policisë me drogën e Lazaratit dhe iu shitej të trafikantëve nga Tepelena. Këtë e bënë banditët e Saimir Tahirit. Ne na kanë sulmuar dhe nxjerrë në kërkim si fis sa erdhi në pushtet PS",- tha Aliko gjatë mbrojtjes së tij. Përveç tij, edhe avokatët kërkuan pafajësi sepse, sipas tyre nuk ka asnjë provë që i lidh ata me ngjarjet e ndodhura në Lazarat.


Anëtarët e grupit të Lazaratit dje në gjyq

**PLAGOSJA E ARTAN DIDIT**

Gjatë një operacioni të policisë në Lazarat në vitin 1998 u plagosën 4 forca speciale, mes tyre dhe Artan Didi. Në vitin 1998, persona me armë bllokuan aksin Gjirokastër-Kakavijë. Policia ndërhyri për të liruar aksin rrugor, por persona të armatosur u përgjigjën duke hapur zjarr ndaj policisë.

**AKUZA NDAJ TAHIRIT**

"Policia e Shtetit e nxori me blinda drogën nga Lazarati në vitin 2014 dhe ua shiti trafikantëve nga Tepelena. Këtë e bënë banditët e Saimir Tahirit. Ne na kanë sulmuar dhe nxjerrë në kërkim si fis sa erdhi në pushtet Partia Socialiste", - tha dje Arbjon Aliko, i cili u dënua me 13 vjet heqje lirie.

**DËNIMI PËR ANËTARËT E GRUPIT "LAZARATI"**

| | |
|---|---|
| 1. Arbion Aliko | 13 vite burg |
| 2. Gurgaz Skënderi | 11 vite burg |
| 3. Enrik Skënderi | 10 vite burg |
| 4. Alfred Proko | 10 vite burg |
| 5. Beqo Brahimi | 8 vite burg |

### VENDIMI I GJYKATËS

Senca gjyqësore ndaj 5 të akuzuarve nuk zgjati shumë, por u shoqërua me tension sharje e ofendime nga ana e lazaratasve. Kur gjyqtarja lexoi vendimin, të paktën dy prej të akuzuarve, mes tyre Arbion Aliko nuk pranoi ta dëgjonte në këmbë vendimin e gjykatës dhe u ul në bankën e të akuzarve duke hedhur shpesh akuza e fjalë fyese. "Ju jeni plehra" dëgjohej të thoshte ai nga kafazi i xhamit. Ndërsa në përfundim të procesit, një tjetër i dënuar u largua duke duartrokitur me ironi vendimin. Në fund të seancës, Arbion Aliko (i cili akuzohet dhe për sulmin në vitin 2015 ku mbeti i vrarë dhe efektivi i RENEA-s, Ibrahim Basha) u dënua me 13 vite burg; Gurgaz Skënderi u dënua me 11 vite burg; Erik Skënderi u dënua me 10 vite burg; Beqo Brahimi u dënua me 8 vite burg, ndërsa Alfred Proko u dënua me 10 vite burg. Ata u gjykuan për disa akuza të ngritura asokohe bashkë me kreun e grupit Gate Mahumtaj, por ky i fundit u gjykua me procedurë të përshpejtuar dhe ndodhet në qeli duke vuajtur dënimin. Pesë anëtarët e grupit "Lazarati" që morën dënimin ditën e djeshme kërkuan një proces normal dhe gjatë gjithë procesit nuk kanë pranuar akuzat duke i quajtur të montuara.

**OPERACIONI**



## Vodhi 32 mijë euro, arrestohet përmbaruesi në Tiranë

Ditën e djeshme policia e Tiranës ka vënë në pranga një përmbarues gjyqësor nën akuzën e vjedhjes. Bëhet me dije se i arrestuari është Fatos Alimadhi 50 vjeç, banues në Tiranë. Arrestimi i tij u bë pas një pune 7 mujore në bashkëpunim me prokurorinë e Tiranës, pasi duke shpërdoruar detyrën ka përfituar nëpërmjet vjedhjes shumën prej 32.255 euro. Përmbaruesi gjyqësor i është shmangur hetimit duke zhdukur dosjen përmbarimore në lidhje me shitjen e një apartamenti, ku në ankandin e dytë, në bazë të ligjit, duhet të shitej me vlerë 20% më i ulët se ankandi i pari, por ky apartament është shitur disa herë më ulët se kjo vlerë që parashikon ligji, duke bërë që përmbaruesi të përfitonte shumën prej 32.255 euro. Materialet për operacionin "Debitori" i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale "Vjedhje duke shpërdoruar detyrën".

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

**"Permbaruesi gjyqesor privat Ermir Godaj** zhvillon ankandin e trete per shitjen e pasurise se paluajtshme "¼ pjese ideale takuese e debitorit Hysen Mehmet Kaso, tek pasuria se paluajtshme e llojit apartament, me numer pasurie 4/89+1-3, Volumi 11, Faqe 23 ne Zonen Kadastrale Nr.8130, me siperfaqe prej 78.94 m², e ndodhur ne Tirane, Adresa: Rr.Qemal Stafa, Shkalla 1, Kati 2, Ap.3", per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditorit Refik Çepeli, per shumen 10'400 Usd dhe 165'992 leke. Çmimi me të cilin fillon ankandi i trete është ne vleren 932'478.78 (nenteqind e tridhjete e dy mije e katerqind e shtatedhjete e tete pike shtatedhjete e tete) leke.
**Ankandi i trete zhvillohet ne date 14.02.2018, ora 16.00 ne zyren e përmbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Toptani", Qendra Torre Drin, kt.2, nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471, 0695370060, email : ermirgodaj@zyrapermbarimit.com."**

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

**Permbaruesi gjyqesor privat Ermir Godaj** zhvillon ankandin e dyte per shitjen e pasurise se paluajtshme "Truall", me Nr.Pasurie 7/91, Volumi 14, faqe 97, Zona Kadastrale 8370, me siperfaqe totale 186.70 m², nga e cila ndertese me sip. 62.70 m², e ndodhur ne Rr. "Haxhi Sina", Tirane, per shlyerjen e detyrimit ne favor te kreditoreve Shasime Mera, Ajet Dema, Lirim Kastrati, per shumat 90'144(nentedhjete mije e njeqind e dyzete e kater)Euro dhe 880'015(teteqind e tetedhjete mije e pesembedhjete)Leke.
**Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është ne shumen 67'200(gjashtedhjete e shtate mije e dyqind)Euro.**
**Ankandi zhvillohet ne date 12.02.2018, ora 16.00 ne zyren e përmbaruesit gjyqesor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Toptani", qendra Torre Drin, kt.2, nr.33, Tirane, dhe per informacion mund te kontaktoni ne nr.0682099471, 0684054605, email ermirgodaj@zyrapermbarimit.com.**

**STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON"**
**me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOXHA**

**Dt 05.02.2018 ora 16:00 '**
**Përfundon Ankandi i Tretë për pasurinë:**
***-Pasuria "Apartament" me sip. 55 m2, Nr. pasurie 212/15+1-5, Z. K 2140, Vol. 2, Fq. 33, me adresë Kërcukal (Gosë), Kavajë. Me çmim 1 247 400 Lekë***
**Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Blv.kryesor (ish kinma iliria) ,Kati-2, Durrës, Kontakt Cel 0682096575**

Afera 5 miliardë lekë, në pranga edhe 3 biznesmenë e 6 në hetim. Në banesën e Xhikës gjenden 80 dosje tenderësh

# Skandali me rrugën, arrestohen ish-drejtorët e LSI E PD

## Prokuroria e Elbasanit: Dashamir Xhika dhe Andi Toma shpërdoruan detyrën

**TIRANË**

Abuzimet e kryera në procedurat tenderuese dhe mbikëqyrëse për ndërtimin e rrugës Elbasan-Gjinar kanë çuar në pranga dy ish-drejtorët e përgjithshëm të rrugëve, Dashamir Xhika dhe Andi Toma. Ata u arrestuan me kërkesë të Prokurorisë së Elbasanit pas kallëzimit penal të bërë pak kohë më parë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se ish-drejtori i LSI-së, Xhika u arrestua mbrëmjen e së enjtes në banesën e tij. Gjatë kontrollit të ushtruar në banesë, atij i janë gjetur 80 dosje tenderash të rregullta. Ndërsa, ish-funksionari i Partisë Demokratike, Toma u arrestua ditën e djeshme, pasi të dy akuzohen për shpërdorim detyre. Procedurat për ndërtimin e rrugës në fjalë kanë nisur që në vitin 2009. Prokuroria ka lëshuar 11 urdhër-arreste, ndërsa janë ekzekutuar vetëm 6 prej tyre. Përveç Andi Tomës, ish-drejtor i përgjithshëm nga 2008 deri më 2013 dhe pasuesit të tij Dashamir Xhika, që e drejtoi autoritetin rrugor deri në vitin 2017, janë arrestuar edhe mbikëqyrësi i punimeve në rrugën e Gjinarit dhe njëkohësisht administrator i kompanisë "Zenit-96", Rexhep Tarba si dhe vëllezërit Agron dhe Kujtim Hysa, administratorë të subjektit "Vëllezërit Hysa". Ndërsa, për Rezarta Bokçiun, ish-administratore e subjektit "Arifaj", u vendos masa e sigurisë "arrest shtëpie". Në lidhje me shpërdorimin e fondeve në rrugën në fjalë janë në hetim dhe shtetasit: Lek Tusha, Astrit Qafa, Malvina Kallabaku, Afërdita Basha dhe Kastriot Braha, ndaj të cilëve gjykata ka vendosur masën e sigurisë "detyrim paraqitje".


Andi Toma, ish-drejtori i përgjithshëm i rrugëve


Dashamir Xhika, ish-drejtori i përgjithshëm i rrugëve

**HETIMET**

Arrestimet e dy ish-zyrtarëve të rrugëve dhe i tre personave të tjerë u kryen me vendim të datës 1 shkurt 2018, të Gjykatës së Elbasanit pas kërkesës së prokurorisë. Ish-drejtorët Xhika e Toma akuzohen për shpërdorim detyre, pasi sipas prokurorisë kanë marrë kanë marrë në dorëzim pjesë të objektit, të cilat rezultojnë të mos jenë kryer. Vlera e dëmit të përllogaritur në buxhetin e shtetit arrin rreth 5 miliardë lekë të vjetra. Katër administratorët e subjekteve private akuzohen se kanë përvetësuar fondet e punimeve të pakryera si dhe nuk kanë kryer mbikëqyrjen e punimeve që duhej të kryheshin për ndërtimin e këtij segmenti. "Nga hetimet e kryera ka rezultuar se këta shtetas, sipas detyrave dhe funksioneve që kanë pasur, kanë kryer veprime dhe mosveprimeve të kundërligjshme, që kanë sjellë si pasojë shpërdorimin e fondeve publike në shumën rreth 5 miliardë lekë të vjetra, të dhëna nga buxheti i shtetit për realizimin e objektit "Sistemim Asfaltim rruga e Gjinarit" dhe objekti nuk është realizuar", thuhet në vendimin e gjykatës.

**5**

**MILIARDË LEKË**

Ish-drejtorët e përgjithshëm të rrugëve, Dashamir Xhika Xhika e Andi Toma akuzohen për shpërdorim detyre, pasi sipas prokurorisë, ata kanë marrë në dorëzim pjesë të objektit, të cilat rezultojnë të mos jenë kthyer. Vlera e dëmit të përllogaritur në buxhetin e shtetit arrin rreth 5 miliardë lekë të vjetra.

**SKANDALI ME RRUGËN ELBASAN-GJINAR**

**TË ARRESTUAR**

**1.**Andi Toma, ish-drejtor i Përgjithshëm i ARRSH
**2.**Dashamir Xhika, ish-drejtor i Përgjithshëm i ARRSH
**3.**Rexhep Tarba, mbikëqyrës punimesh
**4.**Agron Hysa, administrator
**5.**Kujtim hysa, administrator

**ARREST SHTËPIE**

**1.**Rezarta Bokçiu, administratore

**DETYRIM PARAQITJE**

**1.**Lek Tushaj, kolaudues
**2.**Astrit Xhafa
**3.**Malvina Kalabaliu
**4.**Afërdita Basha
**5.**Kastriot Braha

## Kryemadhi: Xhika akuzohet për një tender të 2008-ës, kjo është çmenduri, sulm politik

**TIRANË** - Pas arrestimit të ish-kreut të ARRSH-së, Dashamir Xhika për abuzime me fondet në rrugën Gjinar-Elbasan, ka reaguar kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi. E ftuar në emisionin "Java" në TVSH, Kryemadhi tha se arrestimi i ish-zyrtarit të lartë që vinte nga radhët e LSI-së është një sulm i pastër politik. Madje, ajo nuk hezitoi të akuzojë kryebashkiakun e Elbasanit, Qazim Sejdini dhe deputetin e PS-së, Taulant Balla për presione ndaj anëtarëve të LSI-së në Elbasan. "E para, për llogaritarin e LSI-së nuk i kanë gjetur gjë në shtëpi. Arrestimi i djeshëm për mua është një arrestim politik dhe mua më vjen keq për mediat. Doli fillimisht nga mediat pranë Ramës. Në fillim u spekulua se u arrestua për dosjen e rrugës së Elbasanit. Dashamir Xhika akuzohet për një tender të vitit 2008, kjo është çmenduri more. Ai akuzohet se nuk mori në dorëzim një rrugë. Dashamir Xhika është një djalë shumë serioz dhe të përballet me padrejtësinë e Ramës, sepse nuk mund të arrestosh t'i një drejtor të ARRSH-së kështu. Por ky është një arrestim politik të them të drejtën. Është një presion politik që ushtron Taulant Balla me Qazim Sejdinin në strukturat e LSI-së në Elbasan", - tha Kryemadhi.



**SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"**
**SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:**

**1- Apartament** me nr.5/131+1-20, Zk.8532, vol.12, fq.60, me sip.98 m2 e ndodhur ne Lgj."Konferenca e Pezës", Sh.1, K.3, Ap.20, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. ***Çmimi me të cilin fillon ankandi është*** 3,920,000 (tre milion e nëntëqind e njëzetë mijë) Lekë.
**2- Njesi** me nr.4/122+1-N, Zk.8533, vol.11, fq.188, me sip.40 m2 e ndodhur ne Lgj."15 Tetor", P.25, Sh.11, K.1, Ap.N, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. ***Çmimi me të cilin fillon ankandi është*** 4,000,000 (katër milion) Lekë.
**3- Truall** me nr.52/34, Zk.3981, vol.9, fq.192 me sip.3020 m2 e ndodhur ne Sheq, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. ***Çmimi me të cilin fillon ankandi*** 4,800,000 (katër milion e tetëqind mijë) Lekë.
**4- Truall + ndërtesë** me nr.52/44, vol.12, fq.132, Zk.3981, me sip.trualli 6134 m2 dhe me sip.ndërtese 2160.2 m2 e ndodhur në Fshatin Sheq i Madh, Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. ***Çmimi me të cilin fillon ankandi është*** 59,440,000 (pesëdhjetë e nëntë milion e katërqind e dyzetë mijë) Lekë.
**5- Godinë** me nr.3/166, vol.11, fq.242, me sip.totale 290.6 m2, Zk.8534 me vendodhje në Rr."Apollon", Fier. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. ***Çmimi me të cilin fillon ankandi është*** 51,064,000 (pesëdhjetë e një milion e gjashtëdhjetë e katër) Lekë.
**6- Truall** me nr.108/35, Zk.1791, vol.10, fq.248, me sip.500 m2 e ndodhur në Golem, Kavajë. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. ***Çmimi me të cilin fillon ankandi është*** 2,720,000 (dy milion e shtatëqind e njëzetë mijë) Lekë.
**7- Truall** me nr.108/36, Zk.1791, vol.10, fq.249, me sip.2000 m2 e ndodhur në Golem, Kavajë. Kjo pasuri eshte hipotekuar në favor te Banka Raiffeisen sha. ***Çmimi me të cilin fillon ankandi është*** 10,400,000 (dhjetë milion e katërqind mijë) Lekë.

**Ankandi per shitjen e te gjitha pasurive te sipërcituara do te zhvillohet ne date 13.02.2018, ora 16.00 ne seline e shoqerise EPSA SHPK ne adresen Rr "Ismail Qemali", Pall Fratari, K.6, Tirane.**

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

**FTESË PËR OFERTË**

Swisscontact është një fondacion i pavarur i themeluar në 1959 nga përfaqësues të botës së biznesit dhe shkencës, prezent në 33 vende të botës. Fondacioni është i mirënjohur për lidhjet e ngushta me sektorin privat dhe ekspertizën si katalizator i ndryshimeve në fushën e zhvillimit të aftësive. Swisscontact lehtëson proceset për aftësi më të mira dhe sipërmarrje të shëndoshë, si një kusht i domosdoshëm për një sektor privat konkurrues dhe zhvillim socio-ekonomik. Swisscontact, në kuadrin e projektit Skills for Jobs, mandatuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC, për mirëfunksionimin e Qendrave të Karrierës, zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Shkollës, aplikimit të mësimit të kombinuar dhe përmirësimit të infrastrukturës IT në shkollat partnere, kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "**Blerje pajisjesh elektronike 3**".

**Për më shumë informacion në lidhje me thirrjen, ju lutem drejtohuni në faqen zyrtare të Swisscontact Albania, në linkun si më poshtë:**
**http://www.swisscontact.org/en/country/albania/our-office/jobs.html**

Administrata, 1.073 vende vakante për mësues, inxhinierë, ekonomistë

# Drejtoresha e DAP: Ja si të aplikoni

## Koçiu: Procedurat e rekrutimit, për ata që s'janë pjesë e shërbimit civil

Ornela Manjani



Drejtoresha e Departamentit të Administratës Publike, Albana Koçiu

Në administratën publike do të punësohen 1. 073 persona gjatë këtij viti. Drejtoresha e Departamentit të Administratës Publike, Albana Koçiu bën të ditur se është bërë një planifikim për gjithë vitin 2018 i vendeve të lira të punës në administratë, që arrin në 1073. Çdo ditë institucioni do të vijojë me shpalljen pozicioneve të lira. "Çdo kandidat që nuk është pjesë e shërbimit civil bëhet pjesë e tij duke konkurruar për vendet e nivelit ekzekutiv për 665 pozicione, që do të shpallen gjatë vitit 2018. Ndërkohë që përgjegjësit e sektorëve dhe drejtorët e drejtorive janë vende që do të plotësohen nga nëpunës civilë të një kategorie më të ulët. Nëse një punonjës ka një performancë të mirë legjitimohet që të konkurrojë për pozicionin e përgjegjësit të sektorit e kështu me radhë, përgjegjësit e sektorëve për pozicionet e drejtorëve të drejtorive", - thotë Koçiu në një intervistë për TVSH.

**VENDET VAKANTE**

Janë 1.073 vende në administratën shtetërore, të cilat qeveria mendon t'i plotësojë me rekrutime të reja gjatë këtij viti. Në një vendim të marrë dje, Këshilli i Ministrave deklaron se numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2018 në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, është gjithsej 1.073. Sipas kategorive, 20 vende vakante janë në kuadrin e Trupës së Nëpunësve Civilë të Nivelit të Lartë Drejtues (TND), ku përfshihen drejtorë të përgjithshëm të institucioneve kombëtare. Për kategorinë e mesme drejtuese shpallen 83 vende bosh, për kategorinë e ulët drejtuese janë 305 dhe për kategorinë ekzekutive janë 665 vende. Në kategorinë ekzekutive do të kërkohen profesionistë nga sektorët si më poshtë: shkenca juridike, shkenca kompjuterike, audit i brendshëm, shkenca ekonomike, shkenca ekonomike/juridike, shkenca shoqërore, shkenca sociale, histori-filologji, shkenca mjekësore, veterinari, agronomi, shkenca biologjike dhe të ngjashme me to, kimi, Shkenca mjedisore ose të tjera të përshtatshme, shkenca inxhinierike, arkitekturë, arkeologji dhe restaurime, artet e bukura, gjeodezi, shkenca ekzakte, shkenca edukimi, mësuesi dhe arsim i lartë ushtarak/policor. Do të jetë Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, institucioni i ngarkuar për zbatimin e këtij vendimi.

**SI TË BËHENI PJESË E SHËRBIMIT CIVIL**

Aplikimet për vendet e lira në shërbimin civil për pozicionet e lira në institucionet e administratës shtetërore, pra në Kryeministri, ministritë e linjës dhe institucionet e tyre të varësisë bëhen 'online' nëpërmjet faqes zyrtare të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al Për të aplikuar, duhet të krijosh një llogari personale dhe të ngarkosh të gjithë dokumentacionin që kërkohet. http://hrm.gov.al/Regjistrohu.aspx

**VENDET DHE POZICIONET**

**a)** Për Trupën e Nëpunësve Civilë të Nivelit të Lartë Drejtues 20.
**b)** Për kategorinë e mesme drejtuese, 83.
**c)** Për kategorinë e ulët drejtuese, 305.
**ç)** Për kategorinë ekzekutive, 665.
**2-**Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive janë, si më poshtë:

- Shkenca juridike
- Shkenca kompjuterike
- Audit i brendshëm
- Shkenca ekonomike
- Shkenca ekonomike/juridike
- Shkenca shoqërore
- Shkenca sociale
- Histori-filologji
- Shkenca mjekësore
- Veterinari
- Agronomi
- Shkenca biologjike dhe të ngjashme me to
- Kimi
- Shkenca mjedisore, ose të tjera të përshtatshme
- Shkenca inxhinierike
- Arkitekturë
- Arkeologji dhe restaurime
- Artet e bukura
- Gjeodezi
- Shkenca ekzakte
- Shkenca edukimi
- Mësuesi
- Arsim i lartë ushtarak/policor
- Arsim i lartë

### Reforma në shërbimet publike

# Ministri Ahmetaj: Në prill, shërbimi online "e-eksporte"

U zhvillua dje tryeza e dytë publike në kuadër të reformës së shërbimeve publike dhe ecurisë së procesit të derregulimit. Zëvendëskryeministrja Senida Mesi tha se përmes kësaj reforme po bëhen përpjekje për të ulur korrupsionin dhe se së shpejti 100 për qind e shërbimeve do të bëhen 'online'. Ndërkohë, në fjalën e tij, ministri i Financave dhe Ekonomisë u shpreh se qendra e re te 'Doganat' ul korrupsionin dhe shmang kontaktin e drejtpërdrejtë me doganierin. Po ashtu, sipas tij, kjo përkthehet në transparencë dhe në kohë të kursyer, pasi të gjitha shërbimet doganore do të transferohen 'online'. Ahmetaj tha se në mes të prillit pritet të vihet në funksion edhe shërbimi online "e-eksporte". "Brenda mesit të prillit do të vihet në punë shërbimi 'e-eksporte'. Një shërbim 24-orësh, ku përmes tij agjencitë kanë mundësi të kryejnë shërbimin e eksportit. Gjithashtu, do të ndërmerret një hap i tretë në periudhën gusht-shtator, ku do të bëhet gjurmimi i plotë i trafikut komercial, që do të ulë çdo pikëpyetje në ambientin ekonomik mes sipërmarrjes dhe doganave, duke vijuar më tej me procesin e licencimit dhe autorizimeve si dhe vlerësimin e eksporteve. Ndërkohë - shtoi - Ahmetaj në 'Dogana' dhe 'Tatime' janë ndërtuar profile të sipërmarrjes ndër vite, që nënkupton se ato të cilat nuk kanë pasur probleme, nuk do t'i nënshtrohen një kontrolli të detajuar". Ndërkohë, ministrja e Shtetit për Sipërmarrjen, Sonila Qato tha kjo reformë synon lehtësimin, thjeshtëzimin e të gjitha procedurave që ndjekin qytetarët dhe sipërmarrja. Sa u takon lejeve për ushtrim aktiviteti, Qato tha se pajisja me këtë shërbim do të ofrohet nga zyra përkatëse, që sipas saj është kjo e fundit, e cila do të bëjë edhe verifikimin në mënyrë që sipërmarrësi të ketë një dosje të plotë. Ajo tha gjithashtu se, "po punohet që një pjesë e lejeve dhe autorizimeve t'u akordohen Dhomave të Tregtisë, në mënyrë që edhe sipërmarrësit të lidhin kontakte me to".



Arben Ahmetaj, ministri i Financave dhe Ekonomisë

### Nis projekti 4-vjeçar i "FED Invest"

# Rreth 4.6 milionë dollarë mikrokredi

Rreth 4.6 milionë dollarë do të shkojnë për rreth 40 mijë sipërmarrës të vegjël në fushën e bujqësisë. "FED Invest" në bashkëpunim me Agjencinë japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, "JICA" kanë prezantuar nisjen e projektit 4-vjeçar për përfshirjen financiare të ekonomive dhe fermave familjare, që synon zgjerimin e përfshirjes financiare të popullsisë së zonave rurale dhe semi-urbane, mbështetjen e tyre me njohuri financiare dhe teknologjike, informacione mbi tregun, çmimet dhe marketimin e produktit si dhe njohje me praktikat më të mira ndërkombëtare në agro-bujqësi. "Projekti synon të krijojë një njohje dhe përforcim të përbashkët të organizatave që lidhen me përfshirjen financiare, duke rritur në këtë mënyrë kapacitetet e mirkofinancës në Shqipëri. Projekti i bashkëpunimit teknik i 'JICA' do të zgjasë për katër vite dhe do të ofrojë rreth 4.6 milionë dollarë mbështetje. Projekti pritet të përmirësojë jetesën e 40 mijë sipërmarrësve të vegjël përmes rritjes së kapacitetit të investimeve të FED dhe përmirësimit të shërbimeve të tij", tha Hideya Kobayashi, përfaqësues rezident i zyrës së JICA për Ballkanin. "Nisma botërore të përfshirjes financiare, përqafimi i teknologjive të reja janë disa nga drejtimet ku projekti 'JICA' ka vendosur të mbështesë 'FED Invest' për katër vitet në vazhdim". Objektivi kryesor i projektit është përmirësimi i qasjes në shërbime financiare të familjeve të vogla rurale në Shqipëri, duke zhvilluar produkte të tjera financiare dhe jofinanciare, që u përgjigjen në mënyrë fleksibël nevojave të fermerëve. Ekonomia shqiptare bazohet në një segment të madh ekonomish dhe sipërmarrjesh familjare dhe 45 për qind e popullsisë jeton në zonat rurale. Shkalla e përfshirjes financiare në Shqipëri është shumë e ulët.

## Klosi: Ja kriteret që duhen plotësuar nga subjektet

# Prezantohet projekti "100 fshatra", Edi Rama: Lehtësim fiskal i limituar

Ditën e djeshme u prezantua projekti "100 fshatra", i cili parashikon ndërhyrjen e qeverisë në infrastrukturën e fshatrave të përzgjedhur, madje edhe shërbime e financim përmes granteve. Të pranishëm në këtë event ishte edhe kryeministri i vendit Edi Rama, ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi si dhe ministrat e Bujqësisë; Energjetikës dhe infrastrukturës si dhe Kulturës. Rama në fjalën e tij theksoi se të gjithë ata individë apo sipërmarrje që do të investojnë në agro-turizëm në këto 100 fshatra, do tu ofrohen lehtësira fiskale. "Do të zhvillojmë një program shumë intensiv komunikimi me biznesin e madh për të nxitur kthimin e syve në investimet në agroturizëm, që janë investime të vogla për sa i përket parasë që vihet në dispozicion të ndërtimit të strukturave të agroturizmit, po kanë një rikthim me herë më të madh. Programi i lehtësirave fiskale do të jetë i limituar në kohë. Pra, nuk do të jetë i pafundmë", - tha kryeministri. Ky i fundit kërkoi më shumë bashkëpunim nga kryebashkiakët për të prezantuar projekte në këtë fushë e për të përfituar fonde alternative. Ndërkaq ministri Klosi bëri me dije se çdo subjekt që kërkon të ofrojë agroturizëm, duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara dhe të jetë i certifikuar. Kështu fermat bujqësore duhet të kenë, të paktën, 1 ha tokë të mbjellë me kultura bujqësore ose, minimalisht, 0,5 hektarë serra ndërsa fermat blegtorale duhet të mbarështojnë, minimalisht, 10 krerë gjedh ose 100 krerë dele/dhi apo 200 krerë shpendë, por edhe kritere të tjera. "Së bashku me ministrinë e Bujqësisë do të ngremë një grup që do të realizojë certifikimin e fermave bazuar në këto kritere, duke dhënë mbështetjen e vazhdueshme për të realizuar objektivin madhor që këto ferma të shndërrohen në pole të zhvillimit të zonave edhe në një model suksesi që do të ndjekin qindra fshatra të tjerë", - u shpreh Klosi.

**MINISTRI I TURIZMIT E MJEDISIT, BLENDI KLOSI**
"Së bashku me ministrinë e Bujqësisë do të ngremë një grup që do të realizojë certifikimin e fermave bazuar në këto kritere, duke dhënë mbështetjen e vazhdueshme për të realizuar objektivin madhor që këto ferma të shndërrohen në pole të zhvillimit të zonave edhe në një model suksesi që do të ndjekin qindra fshatra të tjerë", - u shpreh Klosi.


Kryeministri Edi Rama gjatë eventit

## Raporti final për 35 institucione të arsimit të lartë, Nikolla: Proces i pandikuar politikisht

# Akreditimi, "Luarasi" vlerësohet maksimalisht

## Gjonça: Universitetet private më të mirë në renditje


Voltiza Duro

Ka përfunduar raporti final i akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë në vend, ku Kolegji Universitar Luarasi ka marrë një vlerësim ekselent. Agjencia britanike mori në shqyrtim plot 35 universitete e në bazë të intervistave apo dokumentacionit, vetëm 4 prej tyre, përshirë këtu edhe "Luarasin", arritën të marrin pikët maksimale duke u akredituar për 6 vite. Kjo agjenci arriti në konkluzionin se "Luarasi" i përmbush maksimalisht të gjitha standardet shtetërore të cilësisë në të 5 fushat e akreditimit. E pranishme në prezantimin e raportit final, ishte dhe ministrja e Arsimit, Sportit e Rinisë, Lindita Nikolla e cila theksoi se procesi i akreditimit ka qenë tërësisht i ndarë nga politika. "Nuk ka asnjë përfaqësuese të kabinetit të ministres së Arsimit, dhe për këtë unë jam absolutisht mirënjohëse dhe e vendosur për të ecur përpara, si një parakusht për të thënë edhe në mënyrë qartë, që është një bord akreditimi tërësisht i ndarë nga politika",-u shpreh Nikolla. Kjo e fundit bëri me dije se do të vijojnë më tej me inspektimet për verifikimin e kritereve ligjore në mënyrë që cilësia e diplomave të jetë e krahasueshme me ato të vendeve më të mira. "Jemi në momentin e duhur pas këtij verifikimi serioz, për të vijuar më pas me akreditimin e programeve, por ne do të vijojmë me detyrën tonë për të proceduar me inspektimin e radhës për verifikimin e kritereve ligjore. Prioriteti ynë në shëndoshjen e institucioneve, cilësi të diplomave të krahasueshme me ato të vendeve më të mira, por patjetër për t'i lidhur në mënyrë integrale me vendet e punës",-shtoi ministrja e Arsimit. Ndërkaq, të gjithë ata universitete që plotësonin pjesërisht kriteret kanë marrë rekomandimet nga agjencia e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë për përmirësimin e kushteve. Më tej, kreu i bordit të akreditimit, Arjan Gjonça, listoi disa nga faktorët ndikues që i renditën universitetet private më mirë se ata publikë. "Nuk është e rastësishme që një grup institucionesh private me 5-6 vite akreditim, kanë dalë në vendin më të mirë. Mos harrojmë që këto institucione kanë pasur një eksperiencë akreditimi dhe vlerësimi, sepse ligji i ka detyruar ato, ndërkohë që ligji duhet të detyronte dhe institucionet publike, por nuk është zbatuar",-theksoi në fjalën e tij Gjonça. Ndërkohë, anëtarët e bordit të akreditimit nënvizuan se 1/3 e shpenzimeve të procesit mbulohet nga buxheti i shtetit, ndërsa pjesa tjetër nga vetë universitetet. I gjithë procesi deri në hartimin e raportit final, mori nën vëzhgim plot 53 universitete, ku 22 prej tyre ishin private dhe 13 të tjerë publikë.



Prezantimi i raportit final të kreditimit

**LINDITA NIKOLLA**

**BORDI I NDARË NGA POLITIKA**

"Nuk ka asnjë përfaqësuese të kabinetit të ministres së Arsimit, dhe për këtë unë jam absolutisht mirënjohëse dhe e vendosur për të ecur përpara, si një parakusht për të thënë edhe në mënyrë qartë, që është një bord akreditimi tërësisht i ndarë nga politika",- u shpreh ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla.



**ARJAN GJONÇA**

**PRIVATËT, EKSPERIENCË AKREDITIMI**

"Nuk është e rastësishme që një grup institucionesh private kanë dalë me 5-6 vite akreditim, kanë dalë në vendin më të mirë. Mos harrojmë që këto institucione kanë pasur një eksperiencë akreditimi dhe vlerësimi, sepse ligji i ka detyruar ato, ndërkohë që ligji duhet të detyronte dhe institucionet publike, por nuk është zbatuar", - theksoi Gjonça.



| Emertimi I IAL ne renditje alfabetike | Afati i Akreditimit ne vite |
|---|---|
| Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi | 2 |
| Akademia e Forcave te Armatosura | 3 |
| Akademia Profesionale e Biznesit | 4 |
| Kolegji Profesional I Tiranes | 5 |
| Kolegji Universitar Beder | 4 |
| Kolegji Universitar Instituti Kanadez I Teknologjise | 5 |
| Kolegji Universitar LOGOS | 3 |
| Kolegji Universitar Luarasi | 6 |
| Kolegji Universitar Pavaresia Vlore | 3 |
| Kolegji Universitar REALD | 5 |
| Kolegji Universitar Wisdom | 3 |
| Kolegji Universitar TBU | 3 |
| Shkolla e Larte Nehemia Gateway | 5 |
| SHLUJ Universiteti Marin Barleti | 6 |
| SHPAL Universiteti Metropolitan Tirana | 5 |
| Universiteti Aldent | 5 |
| Universiteti Aleksander Moisiu, Durres | 4 |
| Universiteti Aleksander Xhuvani, Elbasan | 3 |
| Universiteti Bujqesor I Tiranes | 4 |
| Universiteti Epoka | 4 |
| Universiteti Eqrem Cabej, Gjirokaster | 3 |
| Universiteti Europian i Tiranes | 5 |
| Universiteti Fan S Noli, Korce | 5 |
| Universiteti I Arteve | 4 |
| Universiteti I MjekesiseTirane | 5 |
| Universiteti I New York-ut ne Tirane | 3 |
| Universiteti I Shkodres | 2 |
| Universiteti I Sporteve te Tiranes | 3 |
| Universiteti I Tiranes | 1 |
| Universiteti I Vlores | 3 |
| Universiteti Katolik Zoja e Keshillit te Mire | 6 |
| Universiteti Mesdhetar | 3 |
| Universiteti Polis | 6 |
| Universiteti Politeknik I Tiranes | 3 |
| Universiteti Privat Albanian University | 2 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra permbarimore "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 12 shkurt 2018 nga ora.08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përmbarimore do zhvillohet ankandi i I-rë për shitjen e tre parcelave të ndodhura në L.13, ZK 8518, Plazh, Durrës e konkretisht:pasuritë nr.58/54,vol 17, fq 2; 58/56,fq 3; 58/57, fq 4. Cdo truall ka sipërfaqen prej 600 m² dhe mbi të rëndon një marrëveshje sipërmarrje.

Çmimi fillestar me të cilin hapet ankandi do të jetë:

1) për pasurinë 58/54 është 570020 Euro; 2) për pasurinë 58/56 është 570020 Euro; 3) për pasurinë 58/57 është 198892 Euro.

P.s: Qytetarët/subjektet që dëshirojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të çmimit fillestar si garanci për pjesëmarrje në ankand. Kjo garanci pasurore duhet te jetë e derdhur në BKT, nr.llogarisë Saimir Hoxha PF ( IBAN: AL07 2051 2046 4204 98CL PRCLALLA ).

Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000
E-mail: best.2010@permbarues.al, web: www.permbarues.al

PERFITUESIT

DOKUMENTET

Përfituesit e këstit të parë dhe të dytë, dokumentet në Drejtorinë e Pagesave

# Ish-të përndjekurit, 1000 trashëgimtarët marrin paratë

## *Ministria e Financave: Dorëzoni numrin e llogarisë brenda muajit*

Ornela Manjani

Rreth 1000 fëmijët dhe nipërit ish-të dënuarve politikë do të marrin dëmshpërblimin. Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë joparësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin dokumentet e nevojshme. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të këstit të parë dhe të dytë të dorëzojnë në Drejtorinë e Pagesave numrin e llogarisë për të marrë dëmshpërblimin. "Lista me përfituesit, të cilët janë në radhë për këstin e tyre të dytë, të cilët duhet të përditësojnë numrin e llogarisë bankare si dhe të dorëzojnë fotokopje të mjetit të identifikimit", - thuhet në njoftimin e djeshëm të Ministrisë së Financave. Numri i llogarisë duhet të dorëzohet brenda muajit. Financat nuk kanë bërë ende të ditur se kur do të çelin fondin për pagesat e ish-të përndjekurve, ndërkohë që herë pas here publikojnë lista me dokumentet që duhet të dorëzojnë përfituesit.

**DOKUMENTET**

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një shkronjë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet emri të jetë i njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në rast se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës, apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykate që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative e lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve, që nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

## PËRFITUESIT E KËSTIT TË PARË DHE TË DYTË

| Nr dosje | Vkm | Emer | Atesi | Mbiemer |
|---|---|---|---|---|
| 144 | 509 | Nike | Preke | Toma |
| 144 | 509 | File | Preke | Pati |
| 163 | 502 | Hajdar | Fadil | Hasa |
| 171 | 502 | Liri | Avni | Myrteza |
| 208 | 502 | Telet | Sevet | Peshkepia |
| 296 | 186 | Bam | Sali | Kashari |
| 357 | 1699 | Drite | Bajram | Pervizi |
| 357 | 1699 | Ylber | Bajram | Pervizi |
| 429 | 502 | Nadire | Haxhi | Gjoni |
| 429 | 502 | Ali | Haxhi | Stafa |
| 429 | 502 | Jakup | Ibrahim | Stafa |
| 500 | 502 | Kurt | Bilal | Kola |
| 500 | 502 | Kurt | Bilal | Kola |
| 503 | 509 | Arjana | Ramiz | Toci |
| 503 | 509 | Elvana | Ismen | Toci(isha) |
| 503 | 509 | Shefqet | Ismen | Toci |
| 503 | 509 | Lirije | Ismen | Toci(gashi) |
| 503 | 509 | Bashkim | Ismen | Toci |
| 503 | 509 | Avni | Ismen | Toci |
| 523 | 502 | Tomorr | Elmaz | Kaci |
| 561 | 1699 | Bilal | Skender | Xhetani |
| 670 | 509 | Zyber | Mehmet | Sallaku |
| 670 | 509 | Mehmet | Muharrem | Sallaku |
| 854 | 509 | Alie | Rushan | Ajdar |
| 907 | 497 | Ndoneta | Jorgji | Qendro |
| 914 | 509 | Myzejen | Gani | Gjergjndreaj |
| 914 | 509 | Fatime | Gani | Haxhiraj |
| 914 | 509 | Sami | Gani | Gorja |
| 914 | 509 | Besnik | Mehmet | Gorja |
| 930 | 502 | Hamdi | Mynir | Shehu |
| 930 | 502 | Bexhet | Mynyr | Shehu |
| 930 | 502 | Leonidha | Mynyr | Sheka |
| 930 | 502 | Erjon | Yzeir | Bregu |
| 992 | 382 | Luljeta | Sefedin | Shahini |
| 1017 | 502 | Tahir | Ramiz | Frangu |
| 1217 | 509 | Behare | Belul | Mersini |
| 1237 | 502 | Gjon | Prend | Marku |
| 1237 | 502 | Marije | Prend | Keli |
| 1237 | 502 | Prenda | Prend | Ndokaj |
| 1366 | 502 | Vasil | Peci | Ferro |
| 1370 | 502 | Gjovalin | Llesh | Fufaj |
| 1375 | 502 | Zenel | Imer | Merlika |
| 1375 | 502 | Beram | Imer | Merlika |
| 1375 | 502 | Tomorr | Imer | Merlika |
| 1375 | 502 | Bujar | Imer | Merlika |
| 1427 | 502 | Namik | Karafil | Larti |
| 1436 | 509 | (h)azbije | Shaziman | Dehari (arifaj) |
| 1459 | 502 | Arshi | Abdi | Ndreu |
| 1459 | 502 | Arshi | Abdi | Ndreu |
| 1521 | 502 | Lirim | Xhemal | Llanaj |
| 1521 | 502 | Shpetim | Xhemal | Llanaj |
| 1536 | 497 | Eduard | Fiqiri | Mansaku |
| 1536 | 497 | Albana | Fiqiri | Mancaku |
| 1554 | 497 | Admir | Haxhi | Mukavelati |
| 1615 | 1231 | Ferzilet | Heqerem | Demollari |
| 1665 | 1699 | Jeta | Gafur | Kodra |
| 1666 | 502 | Hekuran | Seit | Dada |
| 1666 | 502 | Mehmet | Seit | Dada |
| 1666 | 502 | Nurije | Seit | Selimja |
| 1666 | 502 | Alije | Seit | Kuminja |
| 1816 | 297 | Keze | Abaz | Beqiraj(vrenozi) |
| 1816 | 297 | Belul | Abas | Vrenozi |
| 1816 | 297 | Feti | Abaz | Vrenozi |
| 1818 | 714 | Bujar | Shuaip | Hoxha |
| 1818 | 714 | Lindita | Shuaip | Rrapaj wu |
| 1818 | 714 | Salushe | Ferman | Hoxha |
| 1857 | 502 | Mirela | Qamil | Mecja |
| 1928 | 1015 | Atixhe | Namik | Agalliu |
| 1959 | 714 | Hava | Istref | Talo |
| 1996 | 509 | Flutura | Beqir | Lala |
| 2031 | 509 | Nike | Zef | Lumaj |
| 2031 | 509 | Vat | Gjelosh | Lumaj |
| 2075 | 509 | Bardhyl | Qemal | Murja |
| 2262 | 502 | Tereze | Kol | Zefi |
| 2262 | 502 | Ndue | Kol | Deda |
| 2262 | 502 | Lize | Kol | Dedgjonaj |
| 2262 | 502 | Dile | Kol | Marku |
| 2333 | 509 | Mbete | Safet | Pasha |
| 2333 | 509 | Jonus | Safet | Hamataj |
| 2333 | 509 | Agim | Rrapo | Resuli |
| 2333 | 509 | Idris | Rrapo | Resuli |
| 2333 | 509 | Zyrako | Rrapo | Resuli |
| 2340 | 509 | Daut | Idriz | Cekaj |
| 2420 | 509 | Lin | Ded | Guri |
| 2467 | 497 | Kalije | Todi | Stamati (merdani) |
| 2467 | 497 | Astrit | Dhimiter | Merdani |
| 2541 | 509 | Hyrjete | Ferit | Plasa |
| 2541 | 509 | Sherjare | Ferit | Zeqo |
| 2662 | 1699 | Lene | Geg | Sala |
| 2875 | 707 | Baki | Nexhip | Xhafaj |
| 2875 | 707 | Xhafer | Hysen | Xhafaj |
| 2875 | 707 | Pashako | Hysen | Hyseni |
| 2875 | 707 | Myseret | Hysen | Xhafaj |
| 2875 | 707 | Zengjine | Hysen | Lezaj |
| 2875 | 707 | Sabri | Skender | Xhafaj |
| 2875 | 707 | Sokol | Skender | Xhafaj |
| 2875 | 707 | Gentjan | Skender | Xhafaj |
| 2875 | 707 | Valbona | Skender | Haderi |
| 2875 | 707 | Almira | Skender | Manaj |
| 2875 | 707 | Majlinda | Skender | Aliaj |
| 2884 | 457 | Kadrie | Saliko | Ahmetaj |
| 2884 | 457 | Hanushe | Saliko | Dike |
| 2884 | 457 | Vendim | Saliko | Braho |
| 2884 | 457 | Kujtim | Saliko | Braho |
| 2903 | 784 | Myftar | Hazir | Lusha |
| 2903 | 784 | Zize | Hazir | Jaku |
| 2903 | 784 | Arif | Hazir | Lusha |
| 2903 | 784 | Xhemal | Dan | Lusha |
| 3160 | 297 | Sokol | Shaban | Ura |
| 3160 | 297 | Valbona | Shaban | Ura |
| 3160 | 297 | Merita | Shaban | Ura |
| 3160 | 297 | Elmira | Shaban | Ura |
| 3193 | 268 | Aferdita | Muharrem | Islamaj |
| 3193 | 268 | Fatbardha | Muharrem | Islamaj |
| 3193 | 268 | Manushaqe | Muharrem | Islamaj |
| 3213 | 502 | Perparim | Safet | Dushi |
| 3213 | 502 | Astrit | Safet | Dushi |
| 3213 | 502 | Elona | Bujar | Dushi |
| 3213 | 502 | Ervis | Bujar | Dushi |
| 3236 | 1147 | Liza | Bib | Filipi |
| 3278 | 509 | Sami | Selman | Vendresha |
| 3278 | 509 | Spartak | Abaz | Vendresha |
| 3278 | 509 | Tajar | Selman | Vendresha |
| 3285 | 509 | Flora | Dajlan | Bakiu |
| 3370 | 509 | Dava | Lek | Tusha |
| 3370 | 509 | Gjon | Lek | Coli |
| 3370 | 509 | Tereze | Lek | Mhilli |
| 3370 | 509 | Drande | Lek | Lleshgegaj |
| 3370 | 509 | Prene | Lek | Malaj |
| 3370 | 509 | Vlash | Mark | Coli |
| 3370 | 509 | Vlash | Mark | Coli |
| 3509 | 509 | Xhemal | Hasan | Luta |
| 3522 | 1069 | Ndue | Nikoll | Ceku |
| 3605 | 502 | Lize | Marash | Syku |
| 3605 | 502 | Florinte | Marash | Picaku |
| 3665 | 1147 | Gjergj | Rrok | Tinaj |
| 3718 | 1147 | Admir | Nuri | Bitincka |
| 3758 | 502 | Eleni | Pandeli | Ilia |
| 3758 | 502 | Thanas | Kristo | Ilia |
| 3758 | 502 | Sofia | Kristo | Barka |
| 3758 | 502 | Vangjel | Kristo | Ilia |
| 3773 | 1015 | Kristo | Mistokli | Gurra |
| 3773 | 1015 | Joani | Mistokli | Gurra |
| 3778 | 502 | Zef | Ndue | Nikolli |
| 3875 | 707 | Dede | Prel | Vata |
| 4030 | 509 | Maksut | Zenun | Gjolena |
| 4030 | 502 | Vezire | Beshir | Leka |
| 4030 | 502 | Kujtim | Ramazan | Gjolena-ca |
| 4270 | 509 | Petro | Avzi | Kollcinaku |
| 4330 | 509 | Myriban | Teki | Besimi |
| 4330 | 509 | Efikat | Teki | Marko |
| 4359 | 502 | Kostandin | Spiro | Nikolla |
| 4523 | 502 | Ryzhdije | Jakup | Muzhaqi |
| 4523 | 502 | Haziz | Jakup | Qytyku |
| 4523 | 502 | Xhemile | Jakup | Poci |
| 4722 | 380 | Drita | Ramadan | Paja(hatija) |
| 4732 | 707 | Ylli | Shaban | Drogu |
| 4732 | 707 | Mimoza | Shaban | Meniku |
| 4732 | 707 | Julian | Shaban | Drogu |
| 4851 | 714 | Anthulla | Jorgo | Naci |
| 4855 | 714 | Mexhide | Shahin | Bunga |
| 4879 | 363 | Aleko | Ndoc | Nikolli |
| 4930 | 390 | Veronika | Mark | Vata |
| 5002 | 509 | Naim | Asllan | Lika |
| 5011 | 297 | Esena | Zyhdi | Nikaj |
| 5174 | 509 | Zade | Dehar | Spata |
| 5174 | 509 | Afrim | Lazam | Puci |
| 5174 | 509 | Shkelzen | Shaban | Imeraj |
| 5174 | 509 | Munire | Ramadan | Koka |
| 5267 | 502 | Gjele | Gjon | Nokaj |
| 5267 | 502 | Mrike | Ndue | Nokaj |
| 5267 | 502 | Tushe | Frrok | Nokaj |
| 5271 | 502 | Baftije | Selman | Rusi |
| 5294 | 1231 | Arben | Serjan | Muharemaj |
| 5339 | 784 | Alidije | Asllan | Bregu |
| 5339 | 784 | Mirela | Xhevdet | Vrapi |
| 5339 | 784 | Clirim | Xhevdet | Bregu |
| 5372 | 382 | Fatmir | Halit | Gjoçi |
| 5418 | 502 | Tonin | Gjoke | Kurti |
| 5425 | 502 | Jolanda | Skender | Zefi |
| 6523 | 509 | Ahmet | Ibrahim | Matjani |
| 6523 | 509 | Dashuri | Ibrahim | Dervishi |
| 6679 | 502 | Engjell | Petref | Rushitaj |
| 6736 | 502 | Margarita | Petraq | Morcka |
| 6736 | 502 | Aurora | Vangjel | Leka |
| 6811 | 784 | Masllum | Rahman | Tifekciu |
| 6811 | 784 | Vladimir | Rustem | Tafciu |
| 6842 | 502 | Frederik | Luigj | Coku |
| 6896 | 707 | Negri | Feti | Myftiu |
| 7036 | 1015 | Fatime | Mustafa | Abedini |
| 7036 | 1015 | Agron | Muco | Biraci |
| 7036 | 1015 | Vait | Mustafa | Biraci |
| 7036 | 1015 | Selfiko | Mustafa | Leka |
| 7036 | 1015 | Ruhit | Mustafa | Biraci |
| 7037 | 509 | Sabire | Hajdar | Zekthi |
| 7037 | 509 | Lumturi | Hajdar | Uruci(zekthi) |
| 7037 | 509 | Luan | Hajdar | Zekthi |
| 7037 | 509 | Sadete | Hajdar | Zekthi |
| 7037 | 509 | Bujar | Hajdar | Zekthi |
| 7037 | 509 | Qamil | Hajdar | Zekthi |
| 7037 | 509 | Ilmi | Sulejman | Zekthi |
| 7037 | 509 | Nazmi | Sulejman | Zekthi |
| 7037 | 509 | Refik | Sulejman | Zekthi |
| 7037 | 509 | Hidajet | Nebi | Cullhaj |
| 7037 | 509 | Vule | Qamil | Cullhaj |
| 7037 | 509 | Lumturi | Hajdar | Uruci |
| 7107 | 382 | Xhevdet | Qani | Tafa |
| 7128 | 509 | Shuaip | Bejaz | Mehmeti |
| 7138 | 1015 | Florjan | Nazmi | Gazidedja |
| 7212 | 502 | Llambrini | Sotiri | Kondo |
| 7212 | 502 | Eleni | Sotir | Xoro |
| 7212 | 502 | Harikla | Sotiri | Melo |
| 7212 | 502 | Spiro | Sotir | Xoro |
| 7212 | 502 | Spirulla | Foto | Xoro |
| 7365 | 1015 | Sami | | Xhaferri |
| 7394 | 509 | Haxhi | Jakup | Meta |
| 7394 | 509 | Selvije | Jakup | Cupi |
| 7394 | 509 | Valbona | Adem | Myrtaj |
| 7394 | 509 | Anila | Adem | Kurti |
| 7394 | 509 | Petrit | Adem | Meta |
| 7394 | 509 | Luan | Adem | Meta |
| 7394 | 509 | Osman | Islam | Hastoci |
| 7403 | 502 | Tom | Nikoll | Koci |
| 7441 | 297 | Bari | Ramadan | Cukaj |
| 7441 | 297 | Sabrije | Ramadan | Bisha(cukaj) |
| 7441 | 297 | Lirije | Ramadan | Dulaj(cukaj) |
| 7441 | 297 | Vjollce | Ramadan | Bajraktari(cukaj) |
Piketat e jetës kanë renditje të cilat duhen programuar sipas rëndësisë dhe kohës. Është radha e "Siluetës".

**Ju moderatore, Olta aktore. Cili është burimi i këtij pasioni për të qenë pjesë e ekranit?**

Burimi më i fortë i yni për të dyja ne, kanë qenë prindërit, të cilët na kanë rritur me shumë vetëbesim dhe protagonizëm dhe ja ku jemi sot. Që në vogëli, rruga jonë ishte e kuptueshme, sepse unë kam një talent që përveç familjarëve të mi nuk e di njeri, jam imituese e shkëlqyer. Që e vogël imitoja Parashqevi Simakun dhe Vjollca Vokshin të bukurën e TVSH.

**Sa ka ndikuar të pasurit një motër si Olta në karrierën tuaj? A keni pasur propozime për të pasur 1 emision së bashku? E keni menduar ndonjëherë?**

Ne e mbështesim njëra-tjetrën për çdo gjë që lidhet me karrierën. Atij propozimi apo projekti që mund t'i themi "po" duhet të ketë suksesin e garantuar. Nuk duam të eksperimentojmë.









**Cila është ajo pjesë e realitetit të mediave vizive që nuk e toleroni?**

Fasada.

**Cila është pika më e lartë për Gertën që do të ndihej e realizuar?**

Është në karakterin e qenies njerëzore që gjithnjë është në kërkim të një gjëje të re. Kur realizon një qëllim të gjitha përpjekjet apo pengesat që has gjatë rrugës fshihen nga memoria dhe pasi ke arritur atë që do, kërkon përsëri të përballesh me një sfidë të re, mbase edhe më të vështirë. Dhe mendoj se kjo është në karakterin tim. Ndaj nuk i kam vënë vetes limite.

**Cili është rasti me flagrant që keni hasur në media ku vihet re abuzimi apo keqtrajtimi ndaj femrës. A e keni vënë re në RTSH?**

Nuk është një çështje kategorike që të shpallim "viktimat pas lufte". Femra sot është aq e emancipuar dhe ka të gjithë kapacitetin e duhur për të vendosur vetë në zgjedhjet që ndërmerr. Ashtu siç ajo di të përdorë elementet e joshjes, po ashtu ajo duhet të di të shmangë rastet që nuk janë në funksion të sfidave afatgjata.

**Në realitetin e mediave vizive ku jetojmë, më mirë të jesh femër apo mashkull? Kush ka më tepër sukses sipas jush?**

Nuk mendoj se suksesi ndahet sipas gjinisë. Ka modele të suksesshme nga të dyja palët.

## Aurela Gaçe zbulon konkurrenten e saj dhe është vetëm 14 muajshe

Nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Me një talent aq të madh si Aurela Gaçe, vajzat s'kishin si të mbeteshin pas. Vajza e madhe Grace ka treguar se di të këndojë, edhe pse Aurela në intervistat e saj është shprehur se nuk do të dëshironte që vajzat e saj të ndiqnin rrugën e muzikës. Gjithsesi, ajo do t'i mbështesë nëse ato e dua me shpirt këtë gjë. Grace na kishte treguar që këndonte shumë bukur (madje më mirë se mami). Por, tashmë është radha e vajzës së vogël që të dalë në skenë. Abigail Isabelle, edhe pse vetëm 14 muajshe, sfidon motrën e madhe. Ka qenë Aurela, e cila ka publikuar një video në "Instagram", ku dëgjohet Abigail duke kënduar. Besojmë se vite më vonë emri i Aurelës do të zëvendësohet me emrin e dy vajzave të saj, që me siguri do të jenë po aq të talentuara sa mami. "Dardha nën dardhë bie"!




## E pranon publikisht, këngëtarja shqiptare bën operacion plastik vetëm për një klip

Ditët e sotme operacionet plastike janë bërë më se të zakonshme dhe të modës, por të rrallë janë ata artistë që i pranojnë ndërhyrjet e bëra. Ajo që na ka bërë përshtypje është pikërisht këngëtarja Rovena Stefa, e cila ka thënë se do t'i nënshtrohet një ndërhyrjeje estetike në trupin e saj. Ajo ka publikuar një foto e shtruar në një klinike private në Tiranë, ku thotë se është duke kryer një operacion plastik me rastin e xhirimit të videos së re muzikore. "Duke bërë operacione plastike, se klipi i ri del më 14 shkurt", thotë këngëtarja e njohur. Nuk dihet nëse pjesa e shtrirë në klinikë do jetë fragment i videos së këtij projekti. Ajo ka zbuluar vetëm se kënga do të quhet "Unaza" dhe i dedikohet dashurisë. Por, ende nuk e dimë se ku do të bëhet ndërhyrja. Presim videoklipin që ta zbulojmë.



## Zbulohet surpriza e Elvana Gjatës. Ja cila është kënga e re që do të sjellë



Pasi doli lajmi se në datën 3 shkurt Elvana Gjata do të mbajë një recital privat në një nga hotelet e Tiranës, një tjetër lajm është zbuluar ditën e djeshme. Këngëtarja do të këndojë për të ftuarit specialë këngë, të cilat nuk i ka nxjerrë akoma në treg. Dy bashkëpunëtorët, të cilët do të kujdesen për artin e Elvanës janë Pirro Çako dhe Darko Dimitrov. Surpriza ka ardhur nga vetë Darko, i cili ka postuar në profilin e tij të "Instagram" një video, ku shfaqet bashkë me kantautorin Pirro Cako dhe në sfond dëgjohet demoja e një kënge. Videoja shoqërohet me mbishkrimin: "Duke punuar për një këngë të re për një artiste të mrekullueshme". Mos ndoshta kjo këngë është kënga e re e Elvana Gjatës dhe kantautori sapo na zbuloi surprizën?

## Liani në gjurmët e Vesës dhe Big Bastës, ja çfarë bën

Prej kohësh familja e Vesa Lumës është shpërngulur për një jetë më të mirë në Zelandën e Re, por kjo nuk do të thotë se Vesa është shkëputur nga fansat e saj. Ajo herë pas here publikon video apo edhe foto të jetës dhe familjes së saj atje. Në postimin e fundit në "Instastory" duket se vogëlushi i çiftit do të ecë në gjurmët e tyre. Liani shfaqet pranë pianos duke shtypur tastat. Si një djalë artistësh nuk kishte se si t'i qëndronte larg muzikës edhe vogëlushi Lian. Ndërkohë që Vesa dhe bashkëshorti i saj, Big Basta vazhdojnë të jenë të angazhuar në muzikë, pasi në videon e publikuar nga Vesa, duket se janë në një studio muzikore.



STUDIMI

# Abacia e zhdukur e Shën Mërisë në Martanesh dhe lidhja me familjen e Kastriotëve

*Gjon Kastrioti, i ati i Gjergj Kastriot Skënderbeut, në principatën e tij ka pasur klerin katolik dhe abacitë katolikë*

*Gjurmët e mbetura dhe si u shua një prej zonave më të rëndësishme historike, ku bashkohej riti roman me atë bizantin*

Prof. Dr. Valter Shtylla

Arkipeshkvi i Durrësit, Pal Engjëlli, që ka jetuar në vitet 1408-1468 ka qenë një nga bashkëpunëtorët më të afërt të Gjergj Kastriot Skënderbeut.

Ai njihet si diplomat dhe këshilltar i Skënderbeut për politikën e jashtme. Veç këtyre fakteve historike, Pal Engjëlli është i njohur në historinë e shqiptarëve si autori i të parit dokumenti të shkruar në gjuhën shqipe.

Kleriku diplomat nga familja aristokrate Dushi nga Durrësi, paraardhësit e së cilës që prej shekullit të XIV kishin marrë mbiemrin e familjes perandorake bizantine Angelos, më 8 nëntor 1462 shkroi "Formulën e Pagëzimit". Në këtë dokument Pal Engjëlli udhëzon besimtarët e vet që në mungesë të meshtarëve duhet të pagëzojnë vetë fëmijët e tyre, me ujë të zakonshëm, duke e përmbyllur ceremoninë me shprehjen "Unë të pagëzoj në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit të Shenjtë". Hartimi i këtij dokumenti të parë të shkruar në gjuhën shqipe u krye në rrethanat kur kryepeshkopi vërejti çrregullime në Dioqezën e Lisit të Matit.

**KISHA E SHËN TRINISË**

Për këtë qëllim, ai organizoi një Kuvend Kishtar në kishën e Shën Trinisë së Matit, ku edhe u shkrua "Formula e Pagëzimit". Kjo është kisha e Shën Trinisë së Shlliut të Matit. Në ditët e sotme, midis katundit Shlli dhe lagjes "Dazaj" të Macukullit, mbi kodrën e Ballës në Dharbëll ndodhen rrënojat e një kishe të vjetër me emrin Shnritat. Pal Engjëlli, autor i "Formulës së Pagëzimit" dhe bashkëpunëtor i Skënderbeut, nga ana tjetër Abacia e Shën Mërisë së Martaneshit e lidhur me historinë e familjes së Kastriotëve dhe të klerit në zonat e Matit, Durrësit dhe Dibrës, logjika këto që ligjërojnë praninë e kësaj teorie në atë të Formulës së cituar.

Manastir ose Abacia e Shën Mërisë ka gjasa të ketë ekzistuar në fshatin Peshk të krahinës malore veri-lindje të Tiranës, e cila sot njihet me emrin Martanesh. Në Mesjetë kjo krahinë ndërmjet malësive të Tiranës, Matit dhe Dibrës ka qenë njohur me emrin Hunavi apo Kunavi. Për këtë identifikim shprehen shumë autorë të ndryshëm.

Në hartën e botuar nga Shuflaj, Hunavia ndodhet ndërmjet Durrësit dhe rrjedhës së sipërme të lumit Mat, pikërisht tek Martaneshi i sotëm. Po këtu e vendos Hunavinë edhe Gjergj Akropoliti, pretor i perandorit bizantin Laskalës nga Nikea, në vitin 1258 kur përmend ekspeditat bizantine ndaj arbëreshëve. Pak a shumë në këtë përcaktim pajtohet dhe studiuesi Kristo Frashëri, i cili nuk përkrah mendimin se Hunavija lokalizohet në zonën e Shijakut në Shqipërinë e Mesme.

Lidhur me përkatësinë territoriale në periudhën e Principatave Feudale Shqiptare, rezulton se në vitin 1437 bashkë me krahinat e Dibrës, Matit dhe Gollobordës, zona e Hunavisë (Martaneshi) u përfshi në një vilajet me emrin Juvan-ili (Vilajeti i viseve të Gjonit - dmth të Gjon Kastriotit, i ati i Gjergj Kastriotit).

Në dhjetor 1447 mbreti i Napolit, Alfonsi i V e njeh Gjergj Kastriotin "zot i Krujës dhe i Arbërisë", ku në Arbërinë mesjetare veç të tjerave, përfshinte edhe krahinën e Martaneshit.

Malësia e Kunavisë përmendet dhe në kronikat historike të mesjetës.

Me përhapjen e krishtërimit në Shqipëri, theksohet në shekullin X metropolia e Durrësit me 14 peshkopata vartëse (sufragane), ku përfshihej edhe Kunavia. Gjatë shekullit XI-XII si pasojë e fushatave politike dhe ushtarake në rajon dhe pas ndarjes së kishave në 1054 Metropolia e Durrësit me sufraganet vartëse pësuan lëkundje në orientimet kishtare, herë drejt Papatit e herë drejt Bizantit.

Pas ndarjes në vitin 1054, fuqizohet kisha katolike e Durrësit. Më tej në vitin 1143, Metropolisë Ortodokse të Durrësit i kishin mbetur vetëm katër sufragane (vartëse) nga 14 që kishte pasur dikur, që ishin peshkopatat në veri të saj, Krujë, Kunavia dhe Stefaniaka në Mat, renditje kjo pranëterritoriale, çka dëshmon dhe një herë pozitën e Kunavisë në veri të Durrësit.



*Në foto:* Fshati Peshk i Martaneshit ku ndodhej Abacia e Shën Mërisë



*Në foto:* Shkëmbi i Shën Trinisë mbi Abacinë



*Në foto:* Kroi i Kishës pranë sheshit të Abacisë



*Në foto:* Sheshi ku ngrihej Abacia e Shën Mërisë

Një dokument papal i vitit 1888 shpjegon se Peshkopata e Arbrit u vendos nën varësinë direkte të Selisë së Shenjtë. Me situatat politike pas vitit 1210 kisha e Arbrit ra përsëri nën influencën ortodokse. Pas pushtimit anzhuin të Napolit në vitin 1272, në Principatën e Arbrit u forcuan pozitat e katolicizmit. Megjithatë, në këtë principatë qendrore riti katolik nuk arriti ta spostonte plotësisht atë ortodoks. Këtu ndodhi një përzierje e të dy riteve.

Në Durrës dhe në Arbëri funksionojnë si kisha e manastire katolike, ashtu edhe ortodokse.

**KISHA E MARTANESHIT**

Lidhur me ritin e kishës së Martaneshit përmendim faktin e njohur se Gjon Kastrioti, i ati i Gjergj Kastriot Skënderbeut, në principatën e tij ka pasur klerin katolik dhe abacitë katolikë. Në kronikat e tij të vitit 1641, Mark Skura përmend Shën Martinin në tokën e quajtur Shmertin. Motit qe abaci me rentë të madhe, e plotë, me dy kambana dhe më 1050 frymë të krishterë.

Një tjetër autor, duke përmendur Manastirin e njohur të Shën Mërisë në Martanesh hedh mendimin se njëri nga vëllezërit e Skënderbeut mund të jetë varrosur në këtë manastir, siç ka ndodhur me vëllanë e madh Reposhin në Manastirin e Hilandarit në Malin e Shenjtë.

Sipas Shuflait, Dioqeza e Hunavisë është shuar në vitin 1529.

Më pas, në vitin 1641, Kryepeshkopi Mark Skura në këtë vend has kishën e Shën Martinit, e ndërtuar në vendin e Abacisë së moçme të Shën Mërisë. Në këtë fshat të Martaneshit me emrin Peshk banorët kremtonin si festë fetare Shën Martinin dhe pas Hunavisë, pra me kishën e Shën Martinit të fillimit të shekullit XVII, kjo krahinë filloi të njihet me emrin Martenesh-Martinesh-Martanesh. Kisha e Shën Martinit ka arritur deri në fillimin e shekullit të XX, bile themelet e saj janë ruajtur deri në vitet '60-të të këtij shekulli, siç tregojnë vendësit. Ende sot në fshatin Peshk të Martaneshit shkëmbin në sfondin e vendit ku ka qenë kisha, e njohin me emrin domethënës Shkëmbi i Shën Trinisë, gjë që të shtyn për hulumtime historike. Vendi pas shkollës së fshatit quhet Sheshi i Kishës dhe burimi i ujit pranë quhet Kroi i Kishës, aty ku janë gjurmët e kroit të lashtë dhe kisha.

Një tregues i rëndësishëm i marrëdhënieve të familjes së Kastriotëve me Abacinë e Shën Mërisë është edhe fakti se kur Gjergj Kastrioti mori një ndihmë me municione artilerie nga mbreti Alfonsi V i Napolit, me anën e karvanëve me kafshë, ai i transportoi ato në bazën e tij të sigurt në Martanesh. Fshati Peshk i Martaneshit gjatë shekullit të XV kishte dy rrugë karvanësh që e lidhnin me Krujën.

Rruga dimërore kalonte nga Plani i Bardhë - Ura e Vashës - Guri i Bardhë - Zall Dajti - Tujani - Kurcaj e në Krujë, ndërsa rruga verore kalonte nga Biza -Shëngjergji - Zall Dajti e në Krujë. Sa i takon kohës së ndërtimit, mund t'i referohemi faktit se sipas Shuflait, Peshkopi i parë i Hunavisë e sufragan i Durrësit u emërua Guaskoni, në vitet 1310-1318. Në këtë mënyrë mund të shprehemi se Abacia e Shën Mërisë në Martanesh të paktën ka ekzistuar që prej shekullit XIII, duke qenë një Kuvend Katolik, qendër e rëndësishme religjioze dhe e familjes së Kastriotëve, të cilën Gjoni me të katër djemtë e vizitonte shpesh me dhurata dhe të holla. Manastiri ka shërbyer edhe si shkollë për përgatitjen e priftërinjve të ri, prej ku më pas studionin teologji në Padova a më gjerë.

Sigurisht Abacia e Shën Mërisë e Hunavisë nuk duhet konfonduar me kishën e Kanovës, emri i së cilës buron nga ai i maleve Candave gjatë Via Egnatias në malet e Polisit Librazhd, e cila në ndryshim nga Abacia e Martaneshit mbante emrin Kisha e Shën Gjon Pagëzorit. Ishte kjo një përpjekje për të identifikuar një Abaci të rëndësishme në Principatën e Arbërisë në domenet e Kastriotëve. Trajtimi historik dhe arkeologjik i kësaj qendre arbërore mund të nxjerrë fakte të panjohura deri më sot për Principatën e Kastriotëve.

Opinioni i Ditës

# Libri "Kadare dhe regjimi komunist" është një mision

Nga dr. Monika Shoshori Stafa

*(Vijon nga faqja e parë)*

... time për të arritur në përpunimin e mendimeve deri te një analizë, e nisur nga kjo, mendoj se ky libër ia ka dalë objektivit të tij. Të paraqesë shkrimtarin në raport me diktaturën aty ku duhej, dhe si ai është vendosur. Janë të ndarë në grupe ata që e duan shkrimtarin dhe ata që hedhin baltë ndaj tij. Kjo që është botuar tashmë nuk është një e vërtetë e fshehur, është një e vërtetë e publikuar si çdo krim, i cili mundohet të fshihet. Fundja sa shumë krime janë munduar të fshihen gjatë kohës së komunizmit?!

Autori i librit, Dashnor Kaloçi është një 'murg' arkivash. Kur punoja temat e mia mbi dokumentarët historikë në arkiv apo kur kërkoja në arkiva mbi doktoraturën time, e shihja gati për çdo ditë Dashin dhe çdo orë. Ajo që vura re më pas gjatë punës me të, mund të them se Dashi ishte i pangopur në sjelljen e të vërtetave të vogla për një ngjarje, derisa ndërtonte si në një puzzle atë të madhen. Kështu ai pati durimin, të ndërtojë këtë libër me të gjitha ngjyrat e errëta të një tiranie të pashembullt që u ndërtua në Lindjen komuniste; nga pothuaj të gjitha kategoritë, që nga intelektualët që e sulmonin Ismail Kadarenë, e deri tek dosja që iu hap nga Sigurimi i Shtetit, Policia Sekrete e shtetit shqiptar. Me këtë libër Kaloçi, sjell ngjarjen e plotë që në shtyp ka 27 vjet që publikohet e paplotë, vetëm gjysma e saj, njëra pjesë e qëllimtë apo vetëm njëra anë e skajshme e saj. Papa Françesku në një dalje publike në Vatikan, aty nga muaji tetor, mbi fake news, tha se; publikimi apo raportimi i shkrimeve apo i librave me artin e një misionari për të vërtetën e plotë, të bën të shenjtë. Ndaj ka dhe një ditë të të shenjtit të gazetarëve dhe shkrimtarëve, të atyre që këtë profesion e shohin si mision, është 24 janari. I shenjti që i prin këtyre njerëzve që punojnë me këtë qëllim është, Francis de Sale, që papa Piu i 11-të e shpalli të shenjtë në 1923. Gazetarët theksoi më tej Papa Francesku në fjalën e tij, ne e dimë që priren drejt arrogancës, kërcënimit dhe padurimit të zbrazët për të botuar të vërteta të paplota. Dashi është e kundërta; me mirësinë njerëzore, durimin kalorësiak dhe urtësinë prej fëmije,

megjithëse në profesion gazetar prej 27 vjetësh, sjell një libër shumë të rëndësishëm, me peshë historike para lexuesit shqiptar, por së pari para studiuesve të letërsisë dhe jo vetëm; para historianëve që studiojnë totalitarizmin shqiptar, i cili ka qenë një model unik në pjesën lindore të kontinentit.

Përveçse është një libër që ka përmbushur një mision, atë të së vërtetës së plotë, ndër të tjera ai ka dhënë shembullin për të ecur në rrugën e gjatë e të vështirë të njohjes së të kaluarës komuniste në Shqipëri, sidomos tek brezat e rinj. Hyrjes në rrugën e përpunimit të të dhënave që na japin dokumentet dhe artefaktet që shoqërojnë këtë dosje, por jo vetëm, modelin, se si ne, na duhet të shkundemi nga një e kaluar e përbashkët e errët; të gjithë sa jemi e të mos jemi më, peng i saj. Shqipëria po ecën drejt në një rrugë tjetër, atë të Shqipërisë që thërrisnin në majin e vitit 1973, kryengritësit në revoltën e burgut të Spaçit; Shqipërinë që e duam si gjithë Europa.




Edhe diçka të fundit; në Bibël ka një shprehje; shumë janë të thirrurit, por pak të zgjedhurit. Kadare provoi me këtë libër, se ishte i thirrur të ishte një yll në yjësinë e botës shqiptare dhe sado baltë të hidhen mbi të, sa herë afron stina e shirave, atij emri i ishte dhënë bekimi i Hyjit për të qëndruar me dinjitet në historinë e kombit shqiptar dhe shqiptarët për ta pasur si hero të fjalës mes vetes.

*(Fjala e mbajtur në promovimin e librit "Kadare dhe regjimi komunist" në Universitetin Europian të Tiranës)*




## HOROSKOPI

### DASHI
Të rebeloheni ndaj një eprori për të kërkuar që të trajtoheni ndryshe nuk do të sillte asgjë të mirë. Është më mirë t'i kuptoni këndvështrimin, por pa ngritur zërin. Përmbajuni rregullave të vendosura, pasi nuk mund të bëni gjithmonë sipas kokës suaj!

### DEMI
Jeni të pavendosur. Nuk dini nëse t'i besoni një detyrë të rëndësishme një personi të ri për ta vënë në provë, ose të veproni si gjithmonë dhe të mos rrezikoni. Gjithçka varet nga rëndësia e çështjes në fjalë dhe varet vetëm nga ju për ta vlerësuar e për të marrë vendim.

### BINJAKET
Nëse në të kaluarën jeni tërhequr për të qenë vetëm, tashmë keni dëshirë të zbaviteni në grup, duke pranuar çfarëdolloj ndryshimi. Ndryshojini pikëpamjet e tuaja për t'ju përshtatur atyre të partnerit tuaj, nëse nuk janë të njëjta.

### GAFORJA
Për të mos lënduar familjarët apo miqtë, jeni duke humbur veçoritë e karakterit tuaj. Ka ardhur koha të gjeni një ekuilibër midis vetes dhe të tjerëve. Çojini përpara me vendosmëri idetë tuaja, nëse jeni të bindur për qenësinë e asaj që thoni.

### LUANI
Nuk nevojiten shfaqje të jashtëzakonshme dashurie, por të paktën bëjani të ditur partnerit që e doni me të vërtetë. Mjafton pak për t'ia shfaqur. Mos gjeni justifikime banale për t'u tërhequr pikërisht në çastin e fundit. Nuk ju shkon!

### VIRGJERESHA
Pavarësisht se dikush është përpjekur, t'ju vërë shkopinj në rrota, arrini që ta falni e të ecni përpara sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Mund t'i kishit bërë të kuptonte personit përgjegjës se nuk duhej luajtur me zjarrin. Por është e kotë të shohësh mbrapa.

### PESHORJA
Mund të synoni një objektiv të rëndësishëm, nën ndikimin e bashkëveprimit të Plutonit dhe Uranit dhe një optimizmi të fuqishëm. Por t'i kesh shpatullat e ngrohta nga fati nuk është e gjitha. Mos u mburrni, por vazhdoni qëndroni i përqendruar në veprimtarinë tuaj.

### AKREPI
Shmangni thashethemet duke mbajtur një qëndrim miqësor. Falë buzëqeshjes suaj, do t'ia dilni të mposhtni çdo kundërshtar, sepse të tjerët e vlerësojnë punën tuaj. Më këmbëngulje dhe besim në vetvete, gjithçka arrihet.

### SHIGJETARI
Disa dyshime rrezikojnë që të mos ju lënë të flini i qetë, por herët a vonë e vërteta del në shesh dhe më në fund do të qetësoheni. Nëse doni t'i jepni fund një lidhjeje që nuk ju përmbush më, mendojeni mirë, por më pas veproni.

### BRICJAPI
Përpiquni të jetoni më shëndetshëm dhe të keni një stil jete të qetë për të shmangur stresin dhe trysninë, që po ndikojnë në mirëqenien tuaj. Nuk është e vështirë të bësh aktivitet fizik, por nevojitet të sforcoheni për të qëndruar në formë.

### UJORI
Edhe pse i dini të gjitha përgjigjet, nuk do të thotë se keni arritur përsosmërinë. Bëni kujdes dhe përpiquni të mos jeni të sigurt në vetvete deri në tepri. Është më mirë të mos e merrni çdo gjë gjithmonë seriozisht dhe jini më të qetë.

### PESHQIT
Sot planetët mund të shkaktojnë dyshime dhe xhelozi pa arsye. Një sqarim me partnerin do të heqë çdo dyshim. Përpara se të tregoni gishtin nga tjetri, shqyrtojeni njëherë ndërgjegjen tuaj. Mbase edhe ju keni diçka për të fshehur.

Opinioni i Ditës

Nga Arton Konushevci

# Qytetarëve u shkelen çdo ditë të drejtat e tyre

*(Vijon nga faqja e parë)*

... Sipas tyre, zbatimi i pamjaftueshëm i ligjeve mbetet një problem i përhapur në të gjitha institucionet në Kosovë.

Avokati i Popullit, Hilmi Jashari, thotë se janë identifikuar mangësi serioze në shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut, te disa grupe të shoqërisë.

"Bën pjesë kategoria e personave të moshuar, kategoria e fëmijëve, grave, personat me aftësi të kufizuar, të cilët pastaj i kanë mundësitë shumë më të vogla si grupe të interesit për të ndikuar edhe te qeveria dhe te politikëbërësit, për realizimin e këtyre të drejtave",-thekson Jashari.

"Normal këtu nuk përjashtohen pakicat, sidomos në këtë rast komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian, që në krahasim me komunitete tjera, si atë boshnjak apo serb janë në pozitë shumë me të cenuar"-, tha Jashari për Radion Evropa e Lirë.

Po ashtu, edhe Behxhet Shala, drejtor ekzekutiv në Këshillin për Mbrojtjen Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Kosovë, thotë për Radion "Evropa e Lirë", se në Kosovës ka shkelje të mëdha të të drejtave të njeriut.

"Në Kosovë të gjitha kategorive të shoqërisë u shkelen të drejtat e njeriut. Ne kemi problem të madh me punësim, konkurse, sepse shumica e konkurseve janë dhe shpallen formalisht derisa personi është në atë vend punë. Ka shkelje të të drejtave të fëmijëve, të cilët nuk kanë mundësi të shkollohen dhe bëjnë punë të rënda që janë të ndaluar me të gjitha ligjet dhe konventat ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve",-thekson Shala.

"Pastaj kemi shkelje të drejtave të personave me nevoja të veçanta, sepse ata diskriminohen në aspektin e punësimit dhe trajtimit të tyre. Kemi shkelje të të drejtave të pakicave në aspektin e krijimit të perspektivës",-deklaroi Shala.




Ai thotë se ligjet, të cilat i ka Kosova, janë të një standardi shumë të lartë. Por, këto ligje, sipas tij, nuk po mund të gjejnë zbatim dhe si rrjedhojë ka shkelje të të drejtave të njeriut. "Kosova, sa i takon infrastrukturës ligjore nuk qëndron asgjë më keq sesa Gjermania, Finlanda, Danimarka, Suedia e vendet më të zhvilluara. Ndërsa, sa i takon zbatimit, ndoshta nuk do të mund të krahasohet as me një shtet mesatar diku në botë",-thotë ai.

"Ky është problemi se nuk ka kapacitet zbatues, as profesional e as material. Mendoj që në Kosovë kur të miratohen ligjet duhet të bëhet përshkallëzimi i tyre dhe të thuhet saktë 'ky ligj miratohet por, zbatimi i tij, është i pamundur në këtë fazë ku gjendet Kosovë",- tha Shala.

Ndërkaq, Avokati i Popullit, Hilmi Jashari thekson se mbetet shqetësues numri jashtëzakonisht i lartë i miratimit të ligjeve me plotësime dhe ndryshime, që në një mënyrë po paraqesin problem për zbatuesit e tyre.

Një faktor tjetër që ndikon në masë të madhe në moszbatim, nënvizon Jashari, është edhe konflikti i dispozitave ligjore, apo ligjeve dhe akteve nënligjore.

"Shumica e [ligjeve], pra mbi 55 për qind, janë ligje me plotësimndryshime që për çdo vit ndryshohen dhe kjo normal ndikon drejtpërdrejtë në atë që njihet si parim i sigurisë juridike, edhe për qytetarin edhe për zbatuesit e ligjit. Kjo vetvetiu pengon zbatuesit e ligjit, për ta zbatuar atë në mënyrë konsekuente", tha Jashari.

Përfaqësuesit e organizatave për të drejtat e njeriut thonë se respektimi i të drejtave të një shoqërie lidhet ngushtë me zhvillimin demokratik që ka një shtet, si dhe me zbatueshmërinë e ligjeve dhe zhvillimin politik, ekonomik dhe social të atij vendi.



# Thjeshtohet në vetëm 14 ditë procedura për punësim në Gjermani

Nga Anila Shuka



> Prej nëntorit të vitit 2017, procedura është thjeshtëzuar. Punëdhënësi nuk kërkon më miratim nga Zyra e Punësimit "Miratimi paraprak nga Zyra e Punësimit nuk është më i nevojshëm"

> "Tani mjafton që kandidati të paraqesë në ambasadën e Gjermanisë të gjitha dokumentet e nevojshme, duke përfshirë edhe vërtetimin nga punëdhënësi"

Që nga nëntori i 2017-ës, procedura e vizave të punës për shtetasit e Ballkanit Perëndimor është më e thjeshtë dhe realizohet brenda një etape. Kur rregullorja për Ballkanin Perëndimor hyri në fuqi, më 1 janar 2016, procedura për marrjen e vizës ishte e dyfishtë. Punëmarrësit shtronin kërkesë për vizë te përfaqësitë e Gjermanisë në vendet e tyre dhe njëkohësisht punëdhënësit kërkonin leje paraprake në Zyrën e Punësimit në vendndodhjen e kompanisë. Kjo procedurë zgjaste me muaj dhe binte ndesh me dëshirën për punësim sa më të shpejtë. Prandaj prej nëntorit të vitit 2017, procedura është thjeshtëzuar. Punëdhënësi nuk kërkon më miratim nga Zyra e Punësimit "Miratimi paraprak nga Zyra e Punësimit nuk është më i nevojshëm", sqaron për "Deutsche Welle"-n, Sascha Andreas Kienzle (Sasha Andreas Kincle) nga Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë. "Tani mjafton që kandidati të paraqesë në Ambasadën e Gjermanisë të gjitha dokumentet e nevojshme, duke përfshirë edhe vërtetimin nga punëdhënësi".

## KONTROLLIMI NË GJERMANI

Pasi të jenë dorëzuar dokumentet në konsullatë, kontrollohen nga autoritetet përkatëse në Gjermani. "Nëse plotësohen të gjitha kushtet, atëherë jepet viza", thotë Kienzle më tej. Me kontrollin e dokumenteve, krahas Ministrisë së Punëve të Jashtme, pjesë e së cilës janë ambasadat, merren edhe Ministria e Brendshme dhe Ministria Federale e Punës dhe e Çështjeve Sociale, nëpërmjet Agjencisë Federale të Punësimit.

## ROLI I ENTIT FEDERAL TË PUNËSIMIT

"Kur shtrohet kërkesa për vizë pune, ne kontrollojmë se a ka ndonjë shtetas gjerman ose europian me të njëjtin kualifikim që ka aplikuar për të njëjtin vend", thotë për "DW", Paul Ebsen, zëdhënës i Agjencisë Federale të Punësimit. Prandaj dokumentet duhet të dërgohen në zyrën e punës të qytetit ku ndodhet vendi i punës dhe pasi të jenë kontrolluar, kthehen sërish. "Zyra e punës kontrollon vetëm formalisht, se a ka ndonjë kandidat të përshtatshëm me shtetësi gjermane ose nga vendet e BE-së për këtë vend. Kjo nuk zgjat më shumë se 14 ditë - siguron Paul Ebsen. - Nëse marrja e një vize zgjat më shumë, kjo varet nga rrethanat individuale të aplikuesit".

## KUSHTET NUK KANË NDRYSHUAR

Kushtet që duhen plotësuar për marrjen e vizës së punës kanë mbetur të njëjtat: punësimi në ndërtim ose gastronomi nuk kërkon as njohuri gjuhe e as njohuri profesionale. Vetëm për infermierët ose kujdestaret mjekësore kërkohen njohuri gjuhe dhe dëshmi licencimi a diplomat e shkollës profesionale. Kushtet përshkruhen në mënyrë të hollësishme në fletushkat informative të ambasadave.

## AZILKËRKUESIT MBETEN TË PËRJASHTUAR

Azilantët mbeten të përjashtuar nga ky rregull. "Azilkërkuesit, që deri 24 muaj para se të shtrojnë kërkesën kanë marrë ndihma në bazë të ligjit të azilërkuesve, nuk kanë të drejtë të marrin vizë pune", thotë Kienzle. Këtu bëjnë përjashtim azilantët që kanë shtruar kërkesën për azil nga 1 janari 2015 deri më 24 tetor 2015, por që deri në 4 maj 2016 u kthyen vullnetarisht në vendet e tyre. Të përjashtuar nga ky rregull janë edhe azilantët që jetojnë në Gjermani. I ashtuquajturi "ndërrim korsie", pra kalimi nga statusi i refugjatit në atë të imigrantit ekonomik, të cilin e kërkojnë tashmë prej kohësh shumë organizata refugjatësh, nuk lejohet ende. Azilantët duhet të kthehen në vendet e tyre për të hyrë sërish si imigrantë në hapësirën Schengen.

*Kushtet që duhen plotësuar për marrjen e vizës së punës kanë mbetur të njëjtat: punësimi në ndërtim ose gastronomi nuk kërkon as njohuri gjuhe e as njohuri profesionale. Vetëm për infermierët ose kujdestaret mjekësore kërkohen njohuri gjuhe dhe dëshmi licencimi a diplomat e shkollës profesionale. Kushtet përshkruhen në mënyrë të hollësishme në fletushkat informative të ambasadave.*

## MBI 35 000 VIZA PUNE PËR BALLKANIN

Në vitin 2017, Gjermania lëshoi 35 200 viza pune për vendet e Ballkanit Perëndimor, siç bën të ditur për "Deutsche Welle"-n Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë. Vendin e tretë e zënë shtetasit nga Kosova (me 6087 viza pune), pas Bosnjë-Hercegovinës (9 913) dhe Serbisë (9 577). Shqipëria (3 126) vjen pas Maqedonisë (5 584), ndërsa Mali i Zi ishte vendi që solli më pak emigrantë ekonomikë (913) në Gjermani, në vitin 2017. Pjesa dërrmuese punojnë në sektorin e ndërtimit dhe gastronomisë, por ka edhe shumë që janë punësuar si pastrues apo kujdestarë shëndetësorë. Specialistët e kualifikuar janë të paktë dhe zënë vetëm 2,5 për qind të gjithë imigrantëve nga Ballkani.

## 'GASTARBEITER' TË RINJ

Viza e punës jepet për aq sa zgjat kontrata. Kur kontratës i përfundon afati, imigrantët duhet të kthehen sërish në vend. Por nëse kanë paguar sigurime shoqërore, ata mund të gëzojnë përfitimet nga asistenca e papunësisë, sigurimet shëndetësore dhe pensionet.

Prandaj nuk përjashtohet mundësia, që sikurse të ashtuquajturit 'Gastarbeiter', edhe imigrantët e dikurshëm të viteve '60 dhe '70, të mbesin në Gjermani, edhe pasi e kanë humbur vendin e punës.

## Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL
1. Të parat në stadium.
2. Lihet një me orar.
6. Një sferë për model.
10. I vocërr ai i Migjenit.
11. Një tregu është në kapitalizëm.
14. Është nofka.
16. Rastet pa set.
17. Gjysmë zanati.
18. Mund të jenë sigurie.
19. Është ekipi që diskuton trofeun.
21. Nuk i tregohen babit.
22. Ndizen për dinamitin.
23. Gjysmë tatimi.
24. Janë pushkë.
26. Paguhen për vonesa.
27. Një tip për të kërcyer
29. Bëhet një duke pranuar.
31. Pak latinisht.
32. Fund dhjetori.
33. Është përemr për gruan
34. Skuadër greke.
37. Një verë në Paris.
38. Ishin shoqëruesit e Panit.
40. Një mund të jetë grosist.
43. Luan derby me Liverpool.
45. Nuk shihet në një të tillë.
46. Vrapojnë në pistë.
47. E famshmja Curie.

VERTIKAL
1. Studiohen nga heraldika.
2. Janë veshje sportive.
3. Një vegël.
4. Carson i fumetti-t.
5. I takojnë fituesit.
6. Kështu janë regjimet despotike.
7. Ndezur në aparaturë.
8. Kush i forcon ka stabilitet.
9. Një lëvizje mashtruese.
10. Janë pemë që prodhojnë lende.
12. Një antropofag.
13. Gjysma e maskës.
15. Është sëmundje diktatorësh.
19. Është zhdukur e nuk bëhet i gjallë.
20. Luajnë pa ujë
22. Pak familjare.
24. Janë kabina detarësh.
25. Kreshniku u volejbollit.
26. Kalimi në kufij.
28. Emri i Cardin.
29. Ishte Aliu i Tepelenës.
30. Një luksoz me 5 yje.
35. Rrjedh një në klepsidër.
36. Gjysmë stolie.
37. Janë baballarët.
39. Nivel pa ekstreme.
41. Ruan në kufij
42. Janë tek në gatra.
44. Kufizojnë trotuaret.

## Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL
1. Një biçikletë dyshe.
7. Pak misterioze.
10. Bel i Maupassant.
12. Është avantazh i yni.
13. Është i lirë kur është vakant.
15. I fundit është mbi të gjithë.
16. Një mund të jetë i integruar.
17. Fillojnë ofensivën.
19. Janë adashët.
22. Janë në guvë.
24. Është kardinal.
25. Tutori pa uri.
27. Është kisha e papës.
29. Lindsay aktore.
31. Thahen me bonifikim.
32. Shkruhet në janar.
33. Hapen me editorial.
35. Pak enigmatike.
36. Rrjetë në tenis.
37. Është numri një.
40. Ente Tregtare Urbane.
41. Kufizojnë elementë.
42. Mund të jenë parabolike.
45. Mbyllin një dritare.
46. Janë pjesë drame.
48. Është në bronz në një film shqiptar.
49. Luarasi aktore.
50. Ishin mongolë të Timurlengut.



VERTIKAL
1. Një fjalë si rrallë, aty këtu.
2. Një pjesë e aparaturës.
3. Një peshë e pastër.
4. Gjysma e Drinit.
5. Në fund të pritjes.
6. I përkasin pakicës kombëtare.
8. Ishte car i tmerrshëm.
9. Është si telefilm.
10. Inicialet e Daudet.
11. Parashtesa e muskulit.
14. Ndërmarrje Kombëtare Mat.
16. Nuk mund të lenë dot mjekër.
18. Është ndenjëse që trashëgohet.
19. Janë mashtrime loje.
20. Janë gjynahet.
21. Hawke aktor.
23. Janë vendet e pazëna.
24. Janë gremina.
26. Janë sektet islamike.
28. Vrau Minotaurin.
30. Janë veprat si Vejusha gazmore.
34. Qeliza e jetës.
38. Kalohet në gjumë.
39. Një sëmundje veshësh.
40. Është e re pas Krishtit.
41. Gjysma e ekipit.
43. Pak nervozizëm.
44. Një pjesë e titullarëve.
46. Inicialet e Delon.
47. Mbetet në fund.

## Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

## SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 8 | | | 9 | 3 | | | |
| 6 | | | | | 8 | | 9 | 7 |
| | 5 | | 7 | | 2 | | | 6 |
| | 9 | 4 | | 3 | 7 | 1 | | |
| 7 | | 2 | | | | 4 | | 8 |
| | | 3 | 8 | 4 | | 9 | | |
| 1 | | | 3 | | 6 | | 8 | |
| 9 | 7 | | 5 | | | | | 3 |
| | | 6 | 1 | 8 | | | 5 | 4 |

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | 7 | 1 | 3 | 5 | 9 | 8 | 2 | 4 |
| 3 | 5 | 4 | 2 | 8 | 7 | 9 | 6 | 1 |
| 8 | 9 | 2 | 1 | 4 | 6 | 5 | 7 | 3 |
| 7 | 4 | 5 | 9 | 2 | 3 | 6 | 1 | 8 |
| 2 | 1 | 6 | 4 | 7 | 8 | 3 | 9 | 5 |
| 9 | 3 | 8 | 5 | 6 | 1 | 2 | 4 | 7 |
| 5 | 2 | 7 | 6 | 3 | 4 | 1 | 8 | 9 |
| 4 | 6 | 9 | 8 | 1 | 5 | 7 | 3 | 2 |
| 1 | 8 | 3 | 7 | 9 | 2 | 4 | 5 | 6 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

## Argëtim filozofik

- "Koha jote është e kufizuar, kështu që mos e humb atë duke jetuar jetën e dikujt tjetër. Mos bjer në kurthin e dogmave, që do të thotë të jetosh me rezultatet e mendimeve të të tjerëve. Mos e lejo zhurmën e opinioneve të të tjerëve të fundosë zërin tënd brendësor. Dhe më e rëndësishmja, kij guximin për të ndjekur zemrën dhe intuitën tënde. Ato tashmë dinë se çfarë dëshiron të bëhesh me të vërtetë. Gjithçka tjetër është dytësore..."

**Steve Jobs**

## KRIPTOSKEME



## KRIPTOSKEME

*Përgjigja e numrit të djeshëm*

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| S | T | A | R | ■ | E | T | I | K | E | T | A | T |
| A | R | M | I | K | ■ | S | T | O | L | I | T | E |
| L | I | O | ■ | R | O | ■ | ■ | M | I | N | A | T |
| L | O | ■ | C | A | B | A | R | E | T | ■ | L | A |
| A | ■ | B | A | T | E | R | I | T | E | ■ | A | R |
| T | R | I | M | E | R | I | T | E | ■ | A | N | E |
| A | R | T | U | R | O | U | I | ■ | M | A | T | T |
| ■ | A | R | S | E | N | ■ | ■ | E | A | ■ | A | ■ |
| A | D | A | ■ | T | ■ | M | E | T | R | I | ■ | C |
| P | A | K | T | ■ | P | I | R | A | T | E | R | I |
| ■ | K | U | A | L | I | T | E | T | I | ■ | E | P |
| L | E | ■ | C | E | P | I | ■ | ■ | N | A | T | A |

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALEKRYQI (1)

FJALEKRYQI (2)



Argëtim filozofik



## Thënie të mençura

- Një sekret i madh i suksesit është të çani jetën si njeri që nuk konsumohet kurrë. **(Albert Shvaicer)**
- Dështimi ka prirje të përmirësohet, suksesi priret drejt përkeqësimit. **(Seneka)**
- Përgojuesi është i ngjashëm me atë që hedh pluhur kundër dikujt tjetër kur era është në drejtim të tij; kështu pluhuri s'bën gjë tjetër veçse i kthehet atij që e hodhi.
- I virtytshmi nuk mund të plagoset dhe dhimbja që tjerët duan t'i shkaktojnë, bie mbi vetë ato.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!

